



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit
të Kosovës

+383 49 738 080
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Faza 2
Str: Radovan Zogoviq
10 000 Prishtina

Propozicionet e Garave të Ligave të Kategorive të Reja për edicionin 2022/23

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



TEB

Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës në mbledhjen e mbajtur më **03.10.2022** konform nenit 23, alineja 1.13 të Statutit të FBK-së, dhe nenit 3 dhe 6 të Rregullores së Garave të FBK-së dhe me propozim të Komesarit të Garave, miraton tekstin e:

PROPOZICIONEVE TË GARAVE PËR EDICIONIN GARUES 2022/2023

NENI 1. DISPOZITAT THEMELORE

- 1.1 Këto Propozicione rregullojnë në mënyrë unike marrëdhëniet ndërmjet gjithë pjesëmarrësve në sistemin e garave nën organizim të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK-së)
- 1.2 Të gjitha garat zhvillohen nën autorizimin e Bordit të FBK-së.
- 1.3 Të gjitha klubet pjesëmarrëse në sistemin e garave janë të obliguara t'i lexojnë këto propozicione dhe të bashkëpunojnë me të gjitha organet e FBK-së. Asnjë klub pjesëmarrës në garat e organizuara nga ana e FBK-së nuk guxon nën asnjë rrethanë:
- 1.4 Që të refuzojë ndeshjen apo të lëshojë fushën e lojës pa përfunduar ndeshja.
- 1.5 Që të refuzojë pjesëmarrjen, apo të lëshojë - braktisë, ceremoninë e hapjes, mbylljes apo ceremoninë e shpalljes së fituesit dhe ndarjes së medaljeve dhe dhuratave.
- 1.6 Që të sillt në mënyrë jokorrekte dhe ofenduese me çka do të ndikojë në zhvillimin normal të garave, funksionet zyrtare të garave apo ceremonive.

Na rast të shkeljes së këtyre dispozitave, Komesari i Garave merr vendim për suspendim të menjëhershëm të klubit apo individit deri në marrjen e vendimit nga ana e Komisionit Disiplinor të FBK-së.

NENI 2. KOMESARI I GARAVE, AKTET NORMATIVE

- 2.1 Organi themelor, i cili udhëheq me garat është Komesari i Garave i FBK-së, të cilin e emëron Bordi i FBK-së.
- 2.2 Duke i udhëhequr garat, Komesari i Garave do t'i zbatojë këto Propozicione, Rregulloren e Garave, të FBK-së, Rregulloren Disiplinore, aktet tjera normative të FBK-së si dhe aktet e FIBA-s.

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



TEB

Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





NENI 3. DOKUMENTET SI SHTOJÇË E KËTYRE PROPOZICIONEVE

3.1. Për çdo sezon garues publikohen shtojcat e këtyre Propozicioneve të cilat përmbajnë:

- 3.1.1. Listat e klubeve anëtare të ligave;
- 3.1.2. Kalendari i garave;
- 3.1.3. Sistemi i garave,
- 3.1.4. Lista e gjyqtarëve;
- 3.1.5. Lista e vëzhguesve; dhe
- 3.1.6. Lartësia e taksës, mëditjes dhe rrugës për kryerjen e funksionit të gjyqtarëve, vëzhguesve dhe gjyqtarëve ndihmës.

Neni 4. Rregullat zyrtare të basketbollit

4.1. Garat në FBK do të zhvillohen me zbatimin e Rregullave zyrtare të Basketbollit, të cilat i publikon Federata Ndërkombëtare e Basketbollit - FIBA, Rregulloreve të FIBA-s, me zbatimin e këtyre Propozicioneve të Garave, Rregullores Disiplinore, Rregullores së Garave dhe akteve tjera në fuqi si dhe vendimeve të FBK-së.

NENI 5. SISTEMI I GARAVE

5.1. Sistemin e garave dhe mënyrën e plotësimit të ligave e miraton Bordi i FBK-së.

NENI 6. KALENDARI I GARAVE

6.1. Kalendarin e garave, ndryshimet dhe plotësimet në të gjitha nivelet i përcakton Bordi i FBK-së me Propozim të Komisarit të Garave.

6.2. Kalendarin e Garave nuk mund të ndryshohet përveç nëse është në interes të përzgjedhjeve nacionale apo në rast të pjesëmarrjes së ekipeve në nivel më të lartë të garave – që gjithashtu është me interes të veçantë.

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



TEB

Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





NENI 7. NUMRI I SKUADRAVE PJESËMARRËSE

7.1 Numri i skuadrave në liga veç e veç si dhe e drejta e garimit në sezonin 2022/2023 iu takon skuadrave në bazë të suksesit të treguar në sezonin 2021/2022. Të drejtë garimi kanë vetëm klubet, të cilat i kanë përmbushur obligimet financiare ndaj FBK-së, numri i të cilëve caktohet me Vendimin e Bordit të FBK-së.

7.2. Klubet në garat shtetërore (U18, U16, U14 dhe U12 në të dy konkurrencat) janë të obliguara që t'i pranojnë dhe t'i zbatojnë Propozicionet e Garave, sistemin e garave, si dhe aktet tjera të FBK-së.

7.3. Në garat shtetërore klubet paraqiten nën emrin zyrtar, gjegjësisht nën emrin e tyre regjistruar. Pranë emrit zyrtar, klubet mund të përdorin edhe emrin e sponsorit dhe atë në gara, medime, në punët komerciale dhe rastet tjera për të cilën do të lajmërojë Komisararin e Garave.

7.4. Me vendim të posaçëm të Bordit të FBK-së përcaktohen skuadrat të cilat do të marrin pjesë në gara ndërkombëtare.

7.5 Interpretimin e këtyre Propozicioneve të Garave e bën Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës.

7.5.1 Në raste të shfaqjes së fuqisë madhore, përfshirë mes tjerash fatkeqësitë natyrore, epidemitë dhe pandemitë, gjendjen e jashtëzakonshme të shprehur apo të nënkuptuar, si dhe çfarëdo situatë të ngjashme që rezulton me nevojën për të ndërprerë garat, Bordi i FBK-së mund të bëjë ndryshimin emergjent të këtyre Propozicioneve të Garave dhe sistemit të garave, duke interpretuar situatën e krijuar dhe vendosur në baza meritore për pezullimin, ndërprerjen e plotë, ndërprerjen e pjesërishtme, ri programimin e garave, anulimin e tërësishëm të stinorit, apo ri përcaktimin e kalendarit të garave apo terminëve të zhvillimit të ndeshjeve, përfshirë edhe marrjen e vendimit për shpalljen e renditjes përfundimtare për secilin nivel të garave dhe ngritjen apo rënien nga niveli i garave.

NENI 8. TËRHEQJA E SHORTIT TË NUMRIT GARUES

8.1. Para fillimit të sezonit të garave, bëhet tërheqja e numrit të ekipit për garat e Ligës.

8.2. Tërheqja e shortit bëhet në praninë e përfaqësuesve të ekipeve, të cilat marrin pjesë në ligën për të cilën tërhiqet shorti.

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



TEB

Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





NENI 9. PALESTRAT DHE TERMINET PËR ZHVILLIMIN E NDESHJEVE

9.1. Çdo klub është i obliguar që më së largu 14 ditë para fillimit të garave të paraqes palestrën, në të cilën do t'i zhvillojë ndeshjet si vendës dhe vërtetimin/marrëveshjen për përdorim të palestrës.

9.1.1. Skuadra vendëse është e obliguar të bëjë paraqitjen e vendit, ditës dhe orës së zhvillimit të ndeshjes më së paku 72 orë para zhvillimit të saj. Paraqitja me shkrim i bëhet Komisarit të Garave në adresën elektronike junior.komesari@basketbolli.com

9.2. Ndashjet zhvillohen sipas kalendarit të garave të përcaktuar më parë për çdo ligë veç e veç dhe atë:

Për Superliga U18, Liga U18, Superliga U16, Liga U16 Lindje-Perëndim, U 16 Vajzat, Superliga U14, Liga U14, U14 Vajzat dhe U12.

9.2.1. Terminet e fillimit të ndeshjeve për gara kampionale mund të jenë:

Dita: E PREMTE.

Fillimi i ndeshjes: 18:00-20:00;

Dita: E SHTUNË dhe E DIEL:

Fillimi i ndeshjes: 11:00-20:00.

9.2.2 Terminet e fillimit të ndeshjeve kampionale dhe të Kupës të cilat zhvillohen në mes javë:

Dita: E MARTË, E MËRKURË, E ENJTE;

Fillimi i ndeshjes: 10:00 – 20:00.

9.3. Ndashjet mund të zhvillohen edhe në termine tjera, me lejin e Komisarit të Garave:

9.3.1. Për transmetimin e ndeshjeve në TV;

9.3.2. Me marrëveshje të skuadrave në mungesë të terminit. Nëse kërkohet që kjo ndeshje të zhvillohet jashtë javës së rregullt sipas kalendarit të garave, e njëjta DUHET të zhvillohet (me lejin me shkrim nga Komisari i Garave) para fillimit të javës së ardhshme kalendarike për shkak të mbarëvajtjes së rregullt të garave.

9.4. Në rast të dënimit të shqiptuar dhe suspendimit të fushës së regjistruar më parë, skuadra vendëse-organizatori është i obliguar që në afat prej 14 ditësh, të lajmërojë Komesarin e Garave për palestrën tjetër të regjistruar në të cilën do t'i zhvillojë ndeshjet si vendës, si dhe ditën dhe kohën e zhvillimit të ndeshjes.

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



TEB

Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





9.5. Datat dhe terminët e ndeshjeve të PLAY-OFF-it dhe PLAY-OUT-it do të përcaktohen para fillimit të sezonit garues.

9.6. Në pjesën përfundimtare të sezonit garues, nëse është nevoja, Komisar i Garave mund të caktojë që disa ndeshje apo të gjitha ndeshjet e xhiros së njëjtë të zhvillohen në ditën dhe orën e njëjtë. Ky Vendim do t'u komunikohet klubeve jo më vonë se 48 orë para terminit të fillimit të ndeshjes nëpërmjet adresës elektronike.

9.7. Sëmundja apo pamundësia e paraqitjes në ndeshje të lojtarëve dhe trajnerëve, zhvillimi i ndeshjeve miqësore apo turneve në vend dhe jashtë vendit, problemet me transport etj, nuk janë raste të arsyeshme për shtyrjen e ndeshjes. Shtyrja e ndeshjes mund të aprovohet me pëlqimin e të dy ekipeve dhe me lejjimin e Komisarit të Garave.

NENI 10. SHTYRJA E NDESHJES.

10.1. Komisar i Garave mund të marrë vendim për shtyrjen e ndeshjes në kërkesë të ekipit që gjatë javës do të zhvillojë ndeshjen e ligës ndërkombëtare, por e njëjta duhet të zhvillohet më së largu gjatë javës së ardhshme kalendarike.

10.2. Nëse ndeshja nuk mund të zhvillohet në terminin e caktuar apo është ndërprerë për shkak të:

- ndërprerjes së energjisë elektrike në pjesë ku gjendet palestra;
- ndërprerjes së komunikacionit;
- fatkeqësive nga moti i ligë të vërtetuara nga enti shtetëror hidro-meteorologjik;
- situatat e përcaktuara me ligj për fatkeqësitë natyrore (zjarri, përmytjet, rreziku etj);
- epidemia e publikuar nga institucioni i autorizuar shtetëror;

Ndeshja duhet të zhvillohet brenda 24 orëve

10.3. Vendimin mbi shtyrjen e ndeshjes për 24 orë e merr vëzhguesi i ndeshjes apo në mungesë të tij Gjyqtari i Parë, duke u bazuar në rrethanat nga neni 10.1.

10.4. Nëse nuk ekzistojnë kushtet për zhvillimin e ndeshjes, kurse organizatori i ndeshjes nuk mund të sigurojë ndonjë palestër tjetër të regjistruar, ndeshja do të shtyhet për ndonjë termin tjetër.

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



TEB

Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





Gjatë organizmit të Programeve të FIBA Evropës YDF (Youth Development Fund) dhe FIBA Europe Girls' Program nga FBK dhe FIBA, për gjeneratat e reja (djem dhe vajza), ndeshjet nuk do të zhvillohen në atë kohë sa zgjasin këto programe. Kjo vlen edhe për programe të tjera që në ndërkohë mund t'i fillojë FBK dhe që janë me interes për zhvillimin e basketbollit ndër gjenerata të reja.

Vërejtje: Njoftohen të gjithë lojtarët, trajnerët, klubet e basketbollit, shkollat e basketbollit të cilat garojnë në të gjitha grupmoshat e kategorive të reja (U18, U16, U14, U12 djem e vajza) se në rast të ndalesës së lojtarëve/eve për pjesëmarrje në testime, grumbullime, kampet nacionale, ndeshjet ndërkombëtare dhe në të gjitha aktivitetet e basketbollit të cilat organizohen nga FBK, ndaj personave përgjegjës të klubeve, lojtarëve/eve, trajnerëve do të hapet Procedurë Disiplinore Konform Nenit 79 të Rregullores Disiplinore të FBK-së.

Neni 79: Lojtari i cili pa arsye vonohet, refuzon pjesëmarrjen në Përfaqësuese ose pa arsye nuk paraqitet në përgatitjet e Përfaqësueses do të dënohet me ndalesë kohore për lojë. Nëse deri të vonesha apo mosardhja ka ndodhur me fajin e klubit: klubi dënohet me të holla, kurse personi përgjegjës i klubit me ndalesë kohore në kryerjen e detyrës.

10.5. Vendimin për terminin e ri të zhvillimit të ndeshjes e merr Komesari i Garave, por ndeshja e shtyrë DUHET të zhvillohet para përfundimit të pjesës së parë, gjegjësisht pjesës së dytë të Garave. Një herë ndeshja e shtyrë nuk MUND të shtyhet përsëri.

10.6. Shpenzimet për ndeshjen e shtyrë do t'i bartë organizatori i ndeshjes të cilat i lejon Komesari i Garave pas marrjes së faturave (llogarive) të shpenzimeve të bëra nga ekipi mik si dhe për personat zyrtarë.

10.7. Ndeshja e ndërprerë për raste të arsyeshme (fatkeqësitë natyrore) do të vazhdohet nga koha dhe rezultati në momentin e ndërprerjes së ndeshjes, si dhe me të gjitha të dhënat nga protokoli i ndeshjes së ndërprerë.

10.8. Nëse të dy ekipet nuk paraqiten në fushë në kohën e caktuar për të zhvilluar ndeshjen, pa paralajmërimin e Komesarit të Garave për shkaqet e mos zhvillimit të ndeshjes, ndeshja nuk do të zhvillohet kurse të dy skuadrat nuk do të marrin nga një pikë sipas rregullit me rastin e humbjes së ndeshjes.

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



TEB

Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





NENI 11. REGJISTRIMI I LOJTARËVE-EVE, E DREJTA PËR TË LUAJTUR

11.1. Në ndeshje mund të paraqiten vetëm lojtarët-et të cilët (cilat) kanë kartelën garuese-licencën, e lëshuar dhe vërtetuar nga ana e organit të FBK-së apo Komesarit të Garave, me kusht që lojtari (lojtarja) nuk është i suspenduar apo nuk vuan dënim.

11.2. Në ndeshje, një ekip mund të paraqes më së shumti 12 (dymbëdhjetë) lojtarë-e dhe jo më pak se 10 (dhjetë). Në të kundërtën ekipet do të sanksionohen sipas këtyre Propozicioneve.

11.3. Kontrollimi mjekësor i lojtarëve-eve është i obliguar të kryhet dy herë, para fillimit të pjesës së parë dhe të dytë të sezonit të garave, gjatë një edicioni garues. Lojtari (lojtarja) që nuk ka bërë kontrollimin mjekësor nuk mund të paraqitet në ndeshje.

11.4. Klubet janë të obliguara që në ndeshje të paraqiten me përbërje më të mirë. Për mosrespektimin e kësaj pike, trajneri dhe personi zyrtar (përfaqësuesi zyrtar apo kryetari) i klubit do të nënshtrohen përgjegjësisë disiplinore.

11.5. Në edicionin garues 2022-2023 çdo kategori duhet të ketë lojtarët sipas vitit që ka të drejtë garimi për atë kategori garash si:

SUPERLIGA U18 2005-2006

Për garat në këtë kategori në edicionin 2022-2023 janë paraqitur 10 skuadra të cilat do të zhvillojnë 27 xhiro të rregullta të basketbollit, me sistem vajtje ardhje të trefishtë.

Pas kampionatit të rregullt në play-off do të ndeshen 1-4 dhe 2-3 deri në dy fitore. Kampioni i U18 Superliga do të shpallet ekipi i cili arrin i pari 2 fitore nga maksimumi 3 ndeshjet e zhvilluara. Ekipa e renditur si e 10-ta do të largohet në Ligën U18.

LIGA U18 2005-2006

Për garat në këtë kategori në edicionin 2022-2023 janë paraqitur 7 skuadra të cilat do të zhvillojnë 14 xhiro të rregullta të basketbollit.

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



TEB

Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





Pas kampionatit të rregullt në play-off do të ndeshen 1-4 dhe 2-3 deri në dy fitore nga maksimumi 3 ndeshje të zhvilluara, kurse kampioni i shpallur në Liga U 18 nga edicioni i ardhshëm do të jetë pjesë e Superliga U18.

SUPERLIGA U16 2007-2008

Për garat në këtë kategori në edicionin 2022-2023 janë paraqitur 10 skuadra të cilat do të zhvillojnë 27 xhiro të rregullta të basketbollit, me sistem vajtje ardhje të trefishtë.

Pas kampionatit të rregullt në play-off do të ndeshen 1-4 dhe 2-3 deri në 2 fitore. Kampioni i U16 Superliga do të shpallet ekipi i cili arrin dy fitore nga maksimumi tre ndeshje të zhvilluara. Skuadrat e renditura si 9 dhe 10 do të largohen në Ligën U16 Lindje-Perëndim.

Në Superligën U16 ndeshjet do të luhen 4 x 10 minuta dhe nuk ka kurrfarë kufizime.

LIGA U16 Lindje -Perëndim 2007-2008

Për garat në këtë kategori në edicionin 2022/2023 janë paraqitur 12 skuadra të ndara në dy grupe Lindje-Perëndim të cilat do të zhvillojnë 10 xhiro të rregullta të basketbollit. Pas kampionatit të rregullt në play-off do të ndeshen 1-4 dhe 2-3 deri në dy fitore. Kampioni i Ligës U16 Lindje dhe U16 Perëndim në grupe do të shpallet ekipi i cili arrin 2 fitore nga maksimumi 3 ndeshje të zhvilluara. Kampionët e shpallur në grupe nga edicioni i ardhshëm do të jenë pjesë e Superliga U16.

Në Ligën U16 ndeshjet do të luhen 4 x 10 minuta dhe nuk ka kurrfarë kufizime.

LIGA U16 Vajza 2007-2008

Për garat në këtë kategori në edicionin 2022-2023 janë paraqitur 8 skuadra të cilat do të zhvillojnë garat me sistem te dyfishte vajtje -ardhje ne total 14 xhiro të rregullta të basketbollit. Pas kampionatit të rregullt në play-off do të ndeshen 1-4 dhe 2-3 deri në 2 fitore. Kampioni i U16 (F) do të shpallet ekipi i cili arrin 2 fitore nga maksimumi 3 ndeshje të zhvilluara.

Në Ligën U16 (F) ndeshjet do të luhen 4 x 10 minuta dhe nuk ka kufizime.

SUPERLIGA U14 2009-2010

Për garat në këtë kategori në edicionin 2022-2023 janë paraqitur 10 skuadra të cilat do të zhvillojnë 27 xhiro të rregullta të basketbollit, me sistem vajtje ardhje të trefishtë.

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



TEB

Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





Pas kampionatit të rregullt në play-off do të ndeshen 1-4 dhe 2-3 deri në 2 fitore. Kampioni i U 14 Superliga do të shpallet ekipi i cili arrin 2 fitore nga maksimumi 3 ndeshje të zhvilluara. Skuadrat e renditura si 10 do të largohet në Ligën U14. Në Superligën U14 ndeshjet do të luhen 4 x 10 minuta dhe nuk lejohet asnjë lloj mbrojtje zonale në gjysmëfushë apo në tërë fushën. Në rastin e parë trajnerit do t'i tërhiqet vërejtja, kurse rastin e parë të përsëritjes sanksionimi do të jetë GT (C) një gjuajtje e lirë dhe pronësia e topit.

- Nuk lejohet mbrojtje zonale dhe çfarëdo mbrojtje e kombinuar njeri/zonë.
- Nuk lejohet luajtja e pick and roll dhe hand-offit.

LIGA U14 2009-2010

Për garat në këtë kategori në edicionin 2022/2023 janë paraqitur 8 skuadra të cilat do të zhvillojnë 14 xhiro të rregullta të basketbollit.

Pas kampionatit të rregullt në play off do të ndeshen 1-4 dhe 2-3 deri në 2 fitore. Kampioni i Ligës U14 do të shpallet ekipi i cili arrin 2 fitore nga maksimumi 3 ndeshje të zhvilluara dhe në edicionin 2023-2024 do të garojë në Superligën U14. Në Ligën U14 ndeshjet do të luhen 4 x 10 minuta dhe nuk lejohet asnjë lloj mbrojtje zonale në gjysmëfushë apo në tërë fushën. Në rastin e parë trajnerit do t'i tërhiqet vërejtja, kurse rastin e parë të përsëritjes sanksionimi do të jetë GT (C) një gjuajtje e lirë dhe pronësia e topit.

- Nuk lejohet mbrojtje zonale dhe çfarëdo mbrojtje e kombinuar njeri/zonë.
- Nuk lejohet luajtja e pick and roll dhe hand-offit.

LIGA U12 LINDJE-PERËNDIM 2011-2012

Për garat në këtë kategori në edicionin 2022-2023 janë paraqitur 11 skuadra të cilat të ndara në dy grupe Lindje-Perëndim ku në total zhvillojnë 10 xhiro, 4 x 2 ndeshje të rregullta të basketbollit.

Pas kampionatit të rregullt në Final Four të organizuar në Grupin Lindje do të takohen 1- 4 dhe 2-3 ,kurse fituesi dhe finalisti i grupit Lindje do të takohen në Final Four për shpalljen e kampionit. Në gjysmëfinale fituesi i U12 Lindje takohet me finalistin e U12 Perëndim dhe finalisti i Grupit Lindje takohet me fituesin e U12 Perëndim.

Në Ligën U12 ndeshjet do të luhen 4 x 10 minuta dhe nuk lejohet asnjë lloj mbrojtje zonale në gjysmëfushë apo në tërë fushën. Në rastin e parë trajnerit do t'i tërhiqet

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



TEB

Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





vērejtja, kurse rastin e parē tē pērsēritjes sanksionimi do tē jetē GT (C) një gjuajtje e lirē dhe pronēsia e topit.

- Nuk lejohet mbrojtje zonale dhe çfarēdo mbrojtje e kombinuar njeri/zonē.
- Nuk lejohet luajtja e pick and roll dhe hand-offit.

5 lojtarē/e + 1 mund tē luajnē nē çerekun e parē

5 lojtarē-e tjerē + 1 ndërrimet e tjera mund tē luajnē nē çerekun e dytē tē gjithē lojtarēt-et mund tē luajnē nē çerekun e tretē dhe tē katērt)

Nē rast se ekipi pērbēhet nga 11 (njēmbēdhjetē) lojtarē-e, ekipi mund tē luaj me 5 lojtarē-e + 1 ndërrim nē çerekun e parē dhe me vetē 5 lojtarē-e (pa ndërrim) nē çerekun e dytē (apo anasjelltas).

Pesē minuta para fillimit tē ndeshjes trajnerēt duhet gjuqtarit ndihmēs tua japin listēn e lojtarē-eve pēr dy çerekēt e parē, skuadra ēshtē e obliguar qē nē secilēn ndeshje duhet tē luaj me sē paku 10 lojtarē- e, e mē sē shumti me 12 lojtarē-e (Nē rast se skuadra vjen me mē pak se 10 lojtarē-e, ndeshja do tē llogaritet jashtē garave, ndērsa skuadra do tē dēnohet me (50 euro)

VĒREJTJE: Komesari i Garave ēshtē pērgjegjēs pēr aplikimin e rregullave tē ligēs dhe ka tē drejtē qē ti sanksionoj ekipet qē nuk i pērmbahen rregullave ose me veprimet e tyre e dēmtojnē FBK-nē dhe promovimin e minibasketbollit nē Kosovē.

11.6. Nē rast tē mos respektimit tē nenit 11.5. Klubi:

11.6.1. Skuadra e cila aktivizon lojtarē qē nuk pērputhen me moshēn e lejuar pēr garat nē atē kategori, pasi ēshtē verifikuar se janē tē regjistruar me shēnime tē rrejtshme ose dokumente tē falsifikuara i shlyhen tē gjitha rezultatet, pērjashtohet nga gara pēr vitin garues nē vijim dhe edicionin e ardhshēm nē atē kategori, ndērsa ndaj personave pērgjegjēs organi i autorizuar disiplinor i FBK-sē do tē marrē masa ndēshkuese nē bazē tē Rregullores disiplinore tē FBK-sē.

NENI 12. LOJTARĒT-ET, PAJISJA

12.1. Ekipi vendēs apo ekipi i parē i shēnuar nē protokoll tē ndeshjes ēshtē i obliguar qē nē ndeshje tē paraqitet me uniforma me ngjyrē tē ndritshme kurse ekipi mik apo ekipi i dytē i shēnuar nē protokoll tē ndeshjes me ngjyrē tē mbylltē, dhe e kundērtā nēse ekipet paraprakisht kanē arritur marrēveshje me shkrim. Ekipi mysafir obligohet tē respektojē ngjyrat e uniformēs sē ekipit vendēs, nēse ato janē paraqitur zyrtarisht nē FBK.

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



TEB

Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





- 12.2. Gjatë prezantimit të ekipit të gjithë lojtarët duhet të jenë të veshur njëjtë.
- 12.3. Kapiteni i ekipit duhet të jetë dukshëm i shënuar në fanellë.
- 12.4. Fanellat e të gjithë lojtarëve duhet të jenë të vendosur në brekë gjatë tërë ndeshjes.
- 12.5. Veshja e bluzave nën fanella e të cilat duken nuk janë të lejuara.
- 12.6. Nuk është i lejuar reklamimi i pijeve alkoolike (përveç verës dhe birrës), cigareve (duhanit) dhe substancave të cilat gjinden në listën e ndaluar të substancave (agjencioni anti-doping botëror - WADA).
- 12.7. Reklama e vendosur në fanellë në asnjë moment nuk guxon të mbulojë numrin apo mbiemrin e lojtarit.
- 12.8 Ekipet janë të obliguara që në fanellat e lojtarëve të vendosin logon - emblemën e FBK-së. Emblema duhet të vendoset në anën e majtë të epërme të fanellës dhe dimensionet e saj nuk guxojnë të jenë më të vogla se 8 cm x 5 cm.

NENI 13. TRAJNERËT

- 13.1. Detyrën e trajnerit apo ndihmës trajnerit mund ta ushtrojë vetëm personi i cili posedon licencën e trajnerit të lëshuar nga Shoqata e Trajnerëve e Kosovës. Nëse ekipi nuk ka trajner apo ndihmës trajner i cili i plotëson kushtet e lartcekura, detyrën e trajnerit do ta ushtrojë kapiteni i ekipit. Në këtë rast një prej përfaqësuesve zyrtarë të ekipit (përfaqësuesi zyrtar, udhëheqësi teknik, mjeku etj.) nuk mund ta ushtrojë detyrën e trajnerit (të qëndrojë në këmbë gjatë ndeshjes, të kërkojë time-out, zëvendësim etj.)
- 13.2. Vetëm trajnerit dhe ndihmës trajnerit (por në asnjë rrethanë të dyve në të njëjtën kohë) i lejohet të qëndrojë në këmbë dhe të komunikojë me lojtarë gjatë ndeshjes, me kusht që të qëndrojë në hapësirën e kufizuar rreth bankinës së ekipit. Ndihmës trajneri në asnjë situatë edhe pse qëndron në këmbë, nuk guxon t'i drejtohet personave zyrtarë të ndeshjes (vëzhguesit dhe gjyqtarëve).

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



TEB

Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





13.3. Trajnerin, në rast të mungesës së ndihmës trajnerit, gjatë ndeshjes mund ta zëvendës ojë kapiteni i ekipit, vetëm në rastet e parapara me Rregullat e lojës së Basketbollit.

13.4. Trajneri dhe ndihmës trajneri janë përfaqësuesit e vetëm të ekipit që mund të komunikojnë me gjyqtarët ndihmës. Gjatë ndeshjes, gjatë ndërprerjeve të lojës dhe ndaljes së orës së lojës, trajneri mund të ankohet në punën dhe objektivitetin e gjyqtarëve ndihmës tek vëzhguesi i ndeshjes, i cili vlerëson se a duhet të lajmërohen gjyqtarët e ndeshjes për këtë.

13.5. Trajneri apo ndihmës trajneri i përjashtuar, përfaqësuesi zyrtar apo cildo person nga fletëparaqitja e lojtarëve për ndeshje, duhet të largohet nga fusha e lojës dhe nëse është nevoja edhe ta lëshojë palestrën.

13.6. Në rast të dënimit të shqiptuar me ndalesë të ushtrimit të detyrës së trajnerit apo ndihmës trajnerit të ekipit, i njëjti në ndeshjen e ardhshme mund të jetë prezent tek shikuesit, por jo në anën në të cilën gjendet banka e ekipit së tij me lojtarë rezervë.

13.7. Nëse në ndeshjen zyrtare miqësore vjen deri te sjellja jo sportive e trajnerit, lojtarit apo shikuesve dhe kjo paraqitet nga ana e personit zyrtar, të njëjtit mund të sanksionohet nga ana e organit të FBK-së me sanksionet të cilat janë në fuqi për ndeshjet kampionale dhe ato të Kupës.

Vetëm trajnerët të cilët e kanë licencën e lëshuar nga FBK-se dhe janë anëtarë të SHTBK-së kanë të drejtë të udhëheqin me ekipet në atë kategori të garave për të cilën janë licencuar dhe kanë kryer obligimet ndaj SHTBK-së ose FBK-së. Në bazë të rregulloreve për licencimin është vendosur se trajnerët që nuk kanë licenca zyrtare dhe trajnimin profesional, nuk kanë të drejtë të udhëheqin me ekipin e basketbollit nga ndonjë klub apo shkollat e basketbollit në garat zyrtare dhe ndeshjet që organizohen nën patronatin e FBK-së.

NENI 14. PERSONAT ZYRTARË TË EKIPIT

14. 1. Udhëheqësi teknik

14.1.1 Udhëheqës teknik i ekipit duhet të jetë shtetas i Republikës së Kosovës.

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



TEB

Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





14.1.2. Komesari i Garave i lëshon më së shumti 2 (dy) licenca para fillimit të sezonit për udhëheqës teknik.

NENI 14.2. PËRFAQËSUESI ZYRTAR

14.2.1 Përfaqësuesi zyrtar i ekipit duhet të jetë shtetas i Republikës së Kosovës. Është përgjegjës për organizimin e ndeshjes, para vëzhguesit të ndeshjes apo gjyqtarit të parë në emër të klubit i cili është organizator i ndeshjes;

14.2.2. Nëse ekipi nuk ka përfaqësues zyrtar apo i njëjti me arsye duhet ta lëshojë fushën, gjatë ndeshjes mund të jetë i zëvendësuar me Udhëheqësin Teknik;

14.2.3. Përfaqësuesit zyrtarë gjatë ndeshjes nuk kanë të drejtë të komunikojnë me vëzhguesin dhe gjyqtarët. Ata janë vetëm të autorizuar që të japin të dhëna për ndeshjen. Nëse ndodh që përfaqësuesi zyrtar të shkojë te tavolina zyrtare, para, gjatë dhe pas ndeshjes për të nxitur tensione, do të sanksionohet sipas rregullave zyrtare të basketbollit dhe kundër tij do të iniciohet, nëse është nevoja, procedura disiplinore.

14.2.4. Përfaqësuesi zyrtar i ekipit është i obliguar që të bëjë paraqitjen e lojtarëve dhe përfaqësuesve zyrtarë në formularin e plotësuar dhe të vërtetuar me vulën e klubit, të cilin duhet të ia dorëzojë vëzhguesit të ndeshjes më së voni 20 minuta para fillimit të ndeshjes së bashku me licencat e lojtarëve dhe përfaqësuesve zyrtarë të ekipit;

14.2.5. Para fillimit të edicionit garues Komesari i Garave i lëshon më së shumti 7 (shtatë) licenca për përfaqësues zyrtarë të skuadrave.

NENI 14.3. MJEKU I EKIPIT DHE MJEKU KUJDESTAR

14.3.1. Organizatori i ndeshjes është i obliguar që të sigurojë mjekun kujdestar, i cili ka në dispozicion mjetet për dhënien e ndihmës së parë.

14.3.2. Mjeku kujdestar duhet të ketë licencën e vërtetuar për sezonin (edicionin) garues nga Komesari i Garave;

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



TEB

Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





14.3.3. Para fillimit të sezonit, Komesari i Garave lëshon më së shumti dy licenca për mjekë për çdo ekip, prej të cilëve vetëm njëri mund të ulet në bankinën e ekipit gjatë ndeshjes;

14.3.4. Para fillimit të ndeshjes, mjeku do t'i prezantohet ekipit mik dhe do ta njoftojë për vendin ku do të jetë gjatë zhvillimit të ndeshjes.

NENI 14.3.5. FIZIOTERAPEUTI

Para fillimi të edicionit garues, Komesari i Garave lëshon vetëm 1 (një) licencë për fizioterapeutin e ekipit. Në raste të jashtëzakonshme mund të lëshohen edhe më shumë licenca, me lejimin e Komesarit të Garave, kurse gjatë zhvillimit të ndeshjes në bankinë mund të ulen edhe 2 (dy) fizioterapeutë, vetëm nëse numri i tërësishëm i personave zyrtarë (pa lojtarët rezervë) nuk kalon numri 7 (shtatë).

14.3.6 PERSONI PËR KONTAKT ME FBK-NË

Çdo klub është i obliguar që të caktojë personin përgjegjës, i cili në emër të klubit do t'i ketë të gjitha autorizimet për kontakte zyrtare me FBK-në. Në informatë klubi është i obliguar që të cekë numrin e telefonit dhe postën elektronike të personit të caktuar.

NENI 15. KUSHTET PËR TË FITUAR LICENCËN PËR PËRFAQËSUESIN ZYRTAR TË EKIPIT

15.1 Çdo ekip para fillimit të edicionit garues mund të kërkojë që t'i lëshohen licencat për personat zyrtarë për çdo detyrë (funksion) veç e veç.

15.2. Kërkesa paraqitet me shkrim e bashkangjitur me një fotografi për çdo person për të cilin klubi aplikon.

15.3. Komesari i Garave mund të refuzojë kërkesën e ekipit për lëshimin e licencës për personin e caktuar, nëse vlerëson se sjellja e tij në edicionin e kaluar garues nuk ka qenë në nivelin e nevojshëm sportiv.

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



TEB

Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





15.4. Komesari i Garave mund të vendosë që të tërheqë licencën e lëshuar, nëse vlerëson se për një gjë të tillë janë krijuar rrethanat gjatë rrjedhjes së ndeshjes, kurse ekipi ka të drejtë që të propozojë ndonjë person tjetër.

NENI 16. E DREJTA NË DHËNIEN E DEKLARATAVE DHE KOMENTIMI I NDARJES SË DREJTËSISË

16.1. Lojtarët, trajnerët, ndihmës trajnerët, personat zyrtarë, si dhe përfaqësuesit tjerë të ekipit, nuk guxojnë të japin deklaratat publike për ndarjen e drejtësisë nga ana e gjyqtarëve, të komentojnë publikisht ndarjen e drejtësisë, si dhe të japin deklaratat të tjera jokorrekte dhe jo sportive më cilat dëmtohet imazhi i ekipit kundërshtar, ligës dhe FBK-së.

16.2. Ankesat të cilat i përkasin ndarjes së drejtësisë, lëshimet në organizimin e ndeshjes dhe vërejtjet tjera i dorëzohen vëzhguesit të ndeshjes më së largu 30 min. pas ndeshjes apo në afat prej 24 orëve Komesarit të Garave.

16.3. Nëse skuadra ka vërejtje në ndarjen e drejtësisë dhe për këtë kërkon të shikojë video xhirimin nga kjo ndeshje, Komesari i Garave në marrëveshje me Komisionin e caktuar paraprakisht, cakton terminin dhe pas shikimit e njofton klubin me rezultatin nga xhirimi i shikuar - analizuar. Klubi i cili ankohet, më parë duhet medoemos të deponojë në llogarinë e FBK-së shumën prej 300,00€, në të kundërtën ankesa do të refuzohet dhe nuk do të shqyrtohet.

ORGANIZIMI I NDESHJES – PARA FILLIMIT TË NDESHJES

Neni 17. Ekipi vendës-organizatori. Obligimet.

17.1. Organizatori është i obliguar që t'i ndihmojë ekipit mik në çdo rast, t'ia caktojë përfaqësuesin e ekipit që t'i ndihmojë dhe të jep informata të nevojshme për ndeshje.

17.2. Organizatori duhet me kohë të paraqesë ndeshjen tek Policia e Kosovës dhe në ndeshje duhet të jetë prezent numër i mjaftueshëm i forcave policore, varësisht nga numri i shikuesve dhe niveli i rrezikshmërisë së ndeshjes. Nëse ndeshja nuk është paraqitur tek PK, Ekipi vendas humb ndeshjen me rezultat zyrtar 20:0.

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



TEB

Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





17.3. Organizatori duhet të sigurojë vend të përshtatshëm për vendosjen e reklamave të sponsorëve të ligës dhe të FBK-së në sallë. Vendosja e reklamave bëhet sipas kontratave që FBK-ja ka me sponsorët e saj. Organizatori i mban përgjegjësitë dhe i nënshtrohet sanksioneve për mos respektimin e dispozitave të marrëveshjes me sponsorë.

17.4. Organizatori është i obliguar që në çdo ndeshje të vendos flamurin shtetëror me dimensione 200 x 96cm në vendin e dukshëm për të gjithë pjesëmarrësit.

17.5. Organizatori është i obliguar që të sigurojë hapësirën e veçantë për përfaqësuesit e akredituar të mediave.

17.6. Organizatori është i obliguar që të sigurojë hapësirën e veçantë, tavolinat punuese për radio dhe TV kanalet.

17.7. Organizatori është i obliguar që të sigurojë personin me pajisje për pastrimin e fushës së lojës, i cili në çdo kohë duhet të jetë afër fushës (prapa panove të reklamave) dhe të veprojë menjëherë në ftesë të gjyqtarëve.

17.8. FBK mban të drejtën e realizimit të marketingut për sponsorët dhe partnerët në fusha të lojës dhe në palestrat ku zhvillohen ndeshjet. Dispozitat e sakta të marketingut precizohen me Udhëzuesin për Marketing, që e miraton Bordi i FBK-së para fillimit të çdo sezoni. Shkeljet ndaj marketingut sanksionohen sipas këtyre Propozicioneve.

NENI 18. PALESTRA

18.1. Ndeshjet në të gjitha nivelet, mund të zhvillohen vetëm në Palestra të cilat i plotësojnë kushtet e parapara me rregullat zyrtare të basketbollit dhe të cilat janë të regjistruara nga ana e Komesarit të Garave.

18.2. Çdo palestër duhet të ketë hyrje zyrtare, të ndarë nga hyrja e shikuesve, e cila mundëson hyrje/dalje të papenguar të ekipeve dhe personave zyrtarë.

18.3. Nëse vërtetohet se salla nuk i plotëson kushtet e parapara me akte normative dhe me këto Propozicione, Komesari i Garave do të caktojë një afat kohor brenda të cilit duhet të mënjanohen të gjitha mungesat, në të kundërtën, do të ndalohet zhvillimi i ndeshjeve në atë palestër.

NENI 19. LOKALET ZYRTARE NË PALESTRA

19.1. Organizatori është i obliguar që të sigurojë lokalet zyrtare në palestër:

- Zhveshtoren për ekipin mik me minimum 24 varëse për rroba, 12 ulëse apo bankinë për persona;
- Zhveshtoren për gjyqtarë me minimum 6 varëse për rroba, tri ulëse dhe tavolinën,
- Lokalin për përpilimin e raportit të vëzhguesit (me kompjuter dhe internet).

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



TEB

Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



automita

Youth Basketball supporters:





19.1.1. Zhveshtoret për lojtarë dhe gjyqtarë duhet të jenë të pajisura me nyje sanitare, me tusha dhe me hapësirë të nevojshme për zhveshjen e 12 lojtarëve.

19.1.2. Në zhveshtore për lojtarë dhe gjyqtarë, organizatori është i obliguar të sigurojë pije të mjaftueshme freskuese (ujë).

NENI 20. FUSHA E LOJËS

20.1. Dyshemeja për lojë duhet të jetë nga parketi apo bazamenti tjetër i cili i plotëson standardet e FIBA-s.

20.2. Fusha e lojës duhet të jetë me dimensione 28x15 metra, sipas rregullave zyrtare të lojës me hapësirë prej 2m rreth fushës së lojës në të cilën nuk guxon të ketë reklama apo diçka tjetër.

20.3. Fusha duhet të jetë e shënuar në pajtim me Rregullat e lojës së Basketbollit. Të gjitha vijat e parapara me rregulla duhet të jenë të shënuara me ngjyrë të njëjtë – e BARDHË, e rekomanduar nga FIBA.

20.4. Fusha e lojës duhet të jetë e ndriçuar njëjtë në çdo pjesë të saj me më së paku 1.500 luksa, e matur 1 (një) metër mbi sipërfaqen e fushës së lojës.

20.5. Lartësia e pikës më të ulët e tavanit - plafonit, gjegjësisht pengesa më e ulët mbi fushë të lojës duhet të jetë 7 (shtatë) metra e matur nga dyshemeja (parketi) e fushës.

NENI 21. BANKINAT PËR EKIPE

21.1. Bankinat për ekipe duhet të jenë mjaft të gjata që në mënyrë komode të ulen 16 persona, apo në vendin e rezervuar për bankinën e ekipit të ketë 16 karrige.

21.2. Në bankinën për lojtarë rezervë kanë të drejtë, kurse gjatë ndeshjes duhet të ulen, këta persona të cilët janë paraqitur në listën paraqitëse të ekipit dhe i posedojnë licencat e vlefshme për sezonin garues:

21.2.1. Trajneri, i cili ka të drejtë të qëndrojë edhe gjatë ndeshjes në hapësirën e kufizuar dhe që i takon ekipit të tij

21.2.2. Trajneri ndihmës, i cili ka të drejtë të qëndrojë gjatë ndeshjes në hapësirën e kufizuar dhe i takon ekipit të tij, ka të drejtë komunikimi vetëm me lojtarët e tij, nëse në atë moment trajneri është i ulur (nuk është e lejuar të qëndrojnë të dytë në të njëjtën kohë).

21.2.3. Udhëheqësi teknik

21.2.4. Përfaqësuesi zyrtar i ekipit

21.2.5. Shtatë lojtarë rezervë

21.2.6. Mjeku

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



TEB

Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





21.2.7. Fizioterapeuti

21.2.8. Ekipi gjatë ndeshjes në bankinë mund të ketë edhe 2 fizioterapeutë, 2 mjekë apo 2 ndihmës trajnerë, por numri i personave zyrtarë jashtë lojtarëve rezervë nuk mund të jetë më i madh se 7 (shtatë).

21.2.9 Në bankina të ekipit ndalohet ulja e personave që janë bartës të posteve më të larta ekzekutive në klubet përkatëse.

21.3. Trajneri, ndimëstrajneri apo personi zyrtar i ekipit nuk ka të drejtë që të jetë në bankinë e ekipit nëse nuk posedon licencën për edicionin garues, të vërtetuar dhe të lëshuar nga Shoqata e Trajnerëve dhe Komesari i Garave.

21.4. Bankina e ekipit mik duhet të jetë e siguruar me mburojë nga pleksiglassi në tërë gjatësinë e bankinës.

NENI 22. TAVOLINA ZYRTARE

22.1. Tavolina zyrtare duhet të jetë e vendosur në mesin e një prej vijave të mesme të fushës (prapa së cilës gjenden bankinat e lojtarëve rezervë të të dy skuadrave).

22.2. Gjatësia e tavolinës zyrtare duhet të ketë më së paku 4 metra në mënyrë që të ofrojë kushte për punën e personave zyrtarë që janë të ulur dhe atë nga ana e majtë në të djathtë:

1. Matësi i 14 dhe 24 sekondave,
2. Matësi i kohës;
3. Vëzhguesi i ndeshjes
4. Procesmbajtësi i protokollit të ndeshjes.

22.3. Në të dy anët e tavolinës zyrtare duhet të jenë të vendosura nga dy karrige për lojtarët që presin për të hyrë në lojë.

22.4. Organizatori është i obliguar që të sigurojë:

- 22.4.1. Treguesit prej numrit 1-5 për gabimet personale (vetjake);
- 22.4.2. Treguesit e gabimeve personale (Bonus);
- 22.4.3. Treguesin e shigjetës së zotërimit alternativ të topit;
- 22.4.4. Protokollin zyrtar të FBK-së- FIBA;
- 22.4.5. Pipin rezervë, në rast defekti të sirenës në semafor apo dëgjimi i dobët i sirenës;

22.4.6. Metrin ose mjetin adekuar për matjen e lartësisë së koshit;

22.5. Mjetet teknike ndihmëse për ndeshje

22.5.1 Kronometrin e dorës për matjen e kohës me mundësi që kohën ta matë prapa dhe vazhdimi i matjes së kohës nga koha e ndalur;

22.5.2. Kronometrin për matjen e 24 sekondave;

22.5.3. Mjetin për të treguar 10 sekondat e fundit të aksionit të ekipit.;

22.5.4. Treguesin e rezultatit (semafori manual).

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



TEB

Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





NENI 23. SEMAFORI ELEKTRONIK

23.1. Semafori për ndeshje duhet të ketë këto mundësi:

23.1.1. Që të masë kohën e lojës prej 10:00 në 00:00 minuta e treguar me numra. Në minutën e fundit të periudhës apo të kohës shtesë, semafori të tregojë edhe të qindtat e sekondës;

23.1.2. Që të tregojë numrin e gabimeve personale (vetjake)/teknike të ekipeve (Bonus);

NENI 24. APARATURA PËR 24 SEKONDA

24.1. Aparaturat (displejet) për matjen e 24 sekondave duhet të jenë të vendosura mbi të dy tabelat e koshave.

24.2. Nëse nuk mund të vendosen mbi tabela, atëherë ato mund të vendosen në dy këndet e kundërta të fushës së lojës.

24.3. Pajisja për matje duhet të ketë mundësinë e resetimit të kohës në 14 sekonda.

NENI 25. TOPI

25.1. Ndashjet e kategorive të reja zhvillohen me 'SPALDING' - TF1000 me emblemë të FBK-së ose ALL Conferenc, kurse të U12 me SPALDING 5

25.2. Organizatori i ndeshjes është i obliguar që të sigurojë 2 (dy) topa në gjendje të rregullt për skuadrën mike më së voni 30 minuta para fillimit të ndeshjes. Gjyqtarit të Parë i dorëzohen topat për zhvillimin e ndeshjes dhe Gjyqtari i Parë vendos për zgjedhjen e topit të lojës.

NENI 26. TEMPERATURA NË PALESTRA

Neni 26.1. Temperatura gjatë zhvillimit të ndeshjes në palestër (sallë) duhet të jetë minimum 10 Gradë Celsius. Nëse ekipi mik pajtohet që ndeshja të zhvillohet në temperaturë edhe më të ulët se 10 Gradë Celsius, ndeshja do të zhvillohet. Nëse ekipi mik nuk pajtohet për të zhvilluar ndeshjen në temperaturë më të ulët se 10 Gradë Celsius, ndeshja do të shtyhet për 24 orë dhe gjatë kësaj kohe ekipi vendës duhet të gjejë sallë më të nxehtë dhe të regjistruar për zhvillimin e ndeshjes. Nëse ekipi vendës brenda këtij afati nuk mund të sigurojë palestër me kushte të përshtatshme, atëherë do ta humb ndeshjen me rezultat zyrtar.

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



TEB

Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





Neni 26.2. Ekipi vendës-organizatori, është i obliguar që vëzhguesit të ndeshjes t'i sigurojë termometrin për çdo ndeshje, nëse është e nevojshme që të bëhet matja e temperaturës në sallë.

Neni 26.4. Organizatori i ndeshjes është i obliguar të sigurojë që fusha e lojës t'i takojë vetëm akterëve të ndeshjes që janë të paraqitur në listat paraqitëse të klubeve dhe zyrtarëve të ndeshjes. Në podium, lejohet vendosja e 100 karrigeve për VIP të klubit vendas, 10 karrigeve për skuadrën mike, 10 për skuadrën vendase dhe atë vetëm në pjesën ballore të tavolinës zyrtare. Nëse konstatohet se ka më tepër karrige të vendosura ato duhet të largohen dhe nëse ato nuk largohen ndeshja nuk do të fillojë. Përgjegjësia për numërimin e karrigeve – ulëseve në dysheme – parter i takon vëzhguesit të ndeshjes.

ORGANIZIMI GJATË KOHËS SË NDESHJES

Neni 27. Fillimi i ndeshjes

27.1. Për fillim të ndeshjes konsiderohet momenti kur gjyqtarët hyjnë në fushë dhe kërkojnë nga kohëmatësi që të lëshojë në funksion orën e ndeshjes që të punojë nga 20:00 në 00:00 minuta.

27.2. Me fillimin e këtyre 20 minutave, vëzhguesi verifikon se organizatori i ka plotësuar të gjitha kushtet dhe dispozitat e rregullave dhe të këtyre Propozicioneve.

27.3. Nëse konstatohet ndonjë mungesë/defekt në ndonjë pajisje apo mos prezenca e gjyqtarit-ëve ndihmës, organizatorit do t'i lejohen jo më shumë se 30 minuta që t'i sjellë në rregull pajisjet apo që të sigurojë gjyqtarin-ët ndihmës.

27.4. Nëse mungesat e konstatuara nuk mund të eliminohen në kohën e caktuar, apo nëse të njëjtat janë shkaktuar pas lëshimit në punë të orës 20:00 minuta para fillimit të ndeshjes, ndeshja do të shtyhet brenda 24 orëve të ardhshme (neni 10).

27.5. Ndeshja mund të zhvillohet apo edhe të përfundohet me mjetet ndihmëse teknike të cekura në nenin 23.5, por me kusht që Gjyqtari i Parë dhe ekipi mik të pajtohen që ndeshja të zhvillohet nën këto kushte, gjë që duhet të konstatohet dhe të

cektohet në Raportin e Vëzhguesit dhe të verifikohet me nënshkrimin e përfaqësuesit zyrtar të ekipit mik.

27.6. Radhitja e veprimeve para fillimit të ndeshjes:

10:00 MINUTA PARA FILLIMIT TË NDESHJES

27.6.4. Trajnerët në ftesë të vëzhguesit të ndeshjes (gjyqtarit të parë), me nënshkrimin e tyre, vërtetojnë lojtarët e paraqitur të ekipit dhe caktojnë pesëshen e cila do të fillojë ndeshjen. Gjatë kësaj

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



TEB

Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





procedure, protokollin e ndeshjes i pari e nënshkruan trajneri i ekipit vendas apo trajneri i ekipit që është shënuar i pari në protokollin e ndeshjes.

06:00 MINUTA PARA FILLIMIT TË NDESHJES

27.6.5. Gjyqtari i parë i fton lojtarët që ta braktisin fushën dhe të vendosen te bankina e tyre për t'u bërë prezantimi i lojtarëve me anë të zërimit;

27.6.6. Së pari prezantimi bëhet i ekipit mik apo ekipit të dytë të shënuar në protokollin e ndeshjes duke filluar nga kapiteni i ekipit, lojtarëve në bazë të numrave në fanellë dhe në fund të trajnerit dhe ndihmës trajnerit. Lojtarët radhiten përgjatë vijës për gjuajtjet e lira.

27.6.7. Pas prezantimit të ekipeve, prezantuesi i prezanton edhe personat zyrtarë (gjyqtarët dhe vëzhguesin) të ndeshjes. Pas përfundimit të prezantimit të pjesëmarrësve, skuadrat përshëndetën në mes veti.

03:00 MINUTA PARA FILLIMIT TË NDESHJES

27.6.8. Koha e mbetur për nxemjen e skuadrave. Kohëmatësi i njofton gjyqtarët.

02:00 MINUTA PARA FILLIMIT TË NDESHJES

27.6.9. Gjyqtari i parë i njofton ekipet që të tërhiqen nga fusha dhe të përgatiten pesëshet për fillimin e ndeshjes.

30 SEKONDA PARA FILLIMIT TË NDESHJES

27.6.10. Kohëmatësi e reseton orën në 10:00 minuta për fillimin e ndeshjes. Pesëshet e caktuara hyjnë në fushën e lojës.

27.6.11. Pas përfundimit të ndeshjes të gjithë lojtarët dalin në fushë, përshëndetën në mes veti dhe kthehen në bankinat e tyre.

NENI 28. RRJEDHA E NDESHJES

28.1. Organizatori i mban të gjitha përgjegjësitë për të gjitha shkeljet dhe incidentet të cilat ndodhin para, gjatë dhe pas përfundimit të ndeshjes.

28.3. Organizatori nuk guxon të lejojë personat jo zyrtarë dhe shikuesit që të cenojnë fushën e lojës në pjesën e rrethuar apo të valëvitni me flamuj përtej pjesës së rrethuar.

28.4. Organizatori është përgjegjës për hedhjen e petardëve dhe gjësendeve tjera në fushë nga ana e shikuesve, pa marrë parasysh se cila anë e shikuesve bënë hedhjen e tyre.

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



TEB

Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





28.5. Në rast të tollovide në fushë apo sallë, organizatori duhet të ndërmarrë masa dhe të mbrojë të gjithë anëtarët e ekipeve, gjyqtarët dhe vëzhguesin. Duhet të sigurojë hyrjen e tyre në zhveshtore, kurse për ekipin mik dhe personat zyrtarë edhe largimin nga qyteti. Nëse incidentet ndodhin nga ana e shikuesve të ekipit mik, të lajmëruar në mënyrë zyrtare, përgjegjës do të jetë ekipi mik.

28.6. Për të gjitha lëshimet sipas këtij neni si dhe tentim sulmet apo sulmet fizike në skuadra, gjyqtarë apo vëzhgues do të caktohen dënimet e përcaktuara sipas këtyre Propozicioneve.

NENI 29. SHPALLJA E REZULTATIT PËRFUNDIMTAR TË NDESHJES

29.1. Vëzhguesi apo Gjyqtari i Parë (nëse në ndeshje nuk ka vëzhgues) më së voni 30 minuta pas përfundimit të ndeshjes janë të obliguar që ta njoftojnë Komesarin e Garave me rezultatin e arritur nëpërmjet telefonit.

29.2. Nëse Komesari i Garave nuk njoftohet me rezultatin përfundimtar, apo nuk njoftohet në mënyrën e përcaktuar me nenin 37.1. vëzhguesi apo Gjyqtari i Parë (nëse nuk ka vëzhgues) do të dënohen në pajtim me kriteriumet e këtyre Propozicioneve.

NENI 30. RAPORTI I VËZHguesIT. PROTOKOLLI

30.1. Raporti i vëzhguesit përmban shënimet e përgjithshme lidhur me ndeshjen, mendimin dhe vlerësimin e vëzhguesit dhe përfundimin e organizimit të ndeshjes.

Raporti i Vëzhguesit duhet të përpilohet me kompjuter (për Superligën e obliguar) e kursesi me dorë.

30.2. Në raportin e vet, vëzhguesi duhet të cek mënyrën e udhëtimit të personave zyrtarë në ndeshje, së bashku apo në mënyrë individuale.

30.3. Vëzhguesi dhe gjyqtarët nuk janë të autorizuar që ta njoftojnë opinionin me raportin e ndeshjes.

PERSONAT ZYRTARË NË NDESHJE

Neni 31. Vëzhguesi

31.1. Detyrën e vëzhguesit në ndeshje e kryen personi i cili gjendet në listën e propozuar nga ana e Shoqatës së Gjyqtarëve të FBK-së, e aprovuar nga Bordi i FBK-së.

31.2. Delegimin e vëzhguesve në të gjitha ndeshjet e bën Komesari i Garave i FBK-së.

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



TEB

Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





31.3. Vëzhguesi delegohet në ndeshje për të siguruar rrjedhën normale të saj sipas kriteriumeve të parapara dhe duhet të bashkëpunojë me gjyqtarë para, gjatë dhe pas ndeshjes. Gjatë ndeshjes është i ulur në mes të procesmbajtësit dhe kohëmatësit.

31.4. Vëzhguesi është përgjegjës për:

31.4.1. Punën dhe funksionimin e gjyqtarëve ndihmës në tavolinën zyrtare;

31.4.2. Kontrollimin e licencave të lojtarëve dhe personave zyrtarë të paraqitur në ndeshje. Është përgjegjës për dokumentacionin e cekur dhe nuk guxon të lejojë që në bankinë të ulet personi i cili nuk posedon licencë.

31.5. Vëzhguesi mund të zëvendësojë gjyqtarin ndihmës, nëse konstaton së është duke gabuar dhe me këtë ndikon në rrjedhën e rregullt të ndeshjes.

31.6. Në rastin e përshkruar në nenin 40.4. bëhet pushimi për zëvendësimin e gjyqtarit ndihmës.

31.7. Vëzhguesi e bënë zëvendësimin prej gjyqtarëve ndihmës apo gjyqtarëve të pranishëm në sallë. Nëse para fillimit të ndeshjes në terminin e caktuar nuk paraqitet një gjyqtar, apo më shumë, vëzhguesi bën zëvendësimin me gjyqtarët e pranishëm nga lista e përcaktuar. Nëse në afat prej 60 minutave nuk plotësohen kushtet nga alineja (qëndrimi) e mëparshme që të fillojë apo vazhdojë ndeshja, Vëzhguesi është i obliguar që ta lajmërojë Komesarin e Garave për caktimin e gjyqtarit-ëve tjerë. Shpenzimet për shtyrjen (pezullimin) e ndeshjes do t'i bartë FBK. Nëse ndodh që në ndeshje nuk është prezent apo nuk do të vjen Vëzhguesi i ndeshjes, atëherë kompetencat e vëzhguesit i merr gjyqtari i parë.

31.8. Vëzhguesi ka për detyrë:

31.8.1. Të vëzhgojë situatën tek shikuesit dhe në rast të nevojës t'i lajmërojë gjyqtarët për të ndërmarrë masa me kohë;

31.8.2. Që në raportin e tij të jep vlerësimin për organizimin e ndeshjes. Është i obliguar që të përshkruajë çdo moment diskutabil;

31.8.3. Që të paraqet kryerësin e shkeljeve të rënda;

31.8.4. Që të njoftojë për rezultatin përfundimtar në pajtim të këtyre Propozicioneve

31.8.5. Nëpërmjet përfaqësuesit zyrtar duhet të sigurojë deklaratat për personat e paraqitur apo të përjashtuar nga loja, të cekë momentet dhe rastet kontestuese për sjellje jo sportive dhe të njëjtat t'i nënshkruan dhe më së voni 30 minuta pas përfundimit të ndeshjes dhe t'ia dorëzojë vëzhguesit. Në raste të këtilla deklarata merret edhe nga gjyqtarët, e sipas nevojës edhe nga personat tjerë zyrtarë dhe anëtarët e ekipeve.

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



TEB

Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





31.9. Në afat prej 48 orëve Vëzhguesi i ndeshjes është i obliguar t'i dorëzojë (dërgojë) në FBK këto dokumente:

31.9.1. Protokollin origjinal dhe Raportin e Vëzhguesit;

31.9.2. Fletëparaqitjet e lojtarëve dhe personave zyrtarë të të dy ekipeve të paraqitur për ndeshje;

31.9.5. Raportet plotësuese nëse nuk ka mjaft hapësirë në formularin e Raportit të vëzhguesit, apo vërejtjet plotësuese të perceptuara pas kompletimit të Raportit.

31.10. Në rast ankese, Vëzhguesi është i obliguar t'i dërgojë në FBK, më së voni 1 (një) orë pas përfundimit të ndeshjes të skenuara në email apo më së voni 24 orë pas ndeshjes t'i dorëzojë në origjinal këto dokumente:

31.10.1. Ankesën në formë shkrimi;

31.10.2. Deklaratat e personave zyrtarë për ngjarjen kontestuese;

31.10.3. Protokollin e ndeshjes;

31.10.4. Raportin e Vëzhguesit.

31.11. Vëzhguesi është i obliguar të arrijë në palestrën ku do të zhvillohet ndeshja, një (1) orë para fillimit të ndeshjes.

31.12. Vëzhguesve iu ndalohej komentimi i të gjitha detajeve në lidhje me ndeshjen e zhvilluar dhe me detajet e cekura në raportin e vëzhguesit.

31.13. Pas përfundimit të ndeshjes, gjyqtarët dhe gjyqtarët ndihmës mund ta braktisin fushën e lojës vetëm pas lejitimit të vëzhguesit të ndeshjes.

31.14. Për përgjegjësinë disiplinore të vëzhguesit vendos Komesari i Garave dhe Bordi i FBK-së në raste të veçanta.

31.15. Vëzhguesi, menjëherë pas përfundimit të ndeshjes është i obliguar që Komesarit të Garave t'ia dërgojë Raportin e Vëzhguesit me anë të postës elektronike.

Neni 32. Gjyqtarët

32.1. Listën e gjyqtarëve për ndarjen e drejtësisë në ndeshje, me propozim të Shoqatës së Gjyqtarëve të FBK-së, e miraton Bordi i FBK-së.

32.2. Delegimin e gjyqtarëve e bënë Komesari i Garave, në bazë të listës së aprovuar nga Bordi i FBK-së.

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



TEB

Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





32.3. Klubet nuk mund të kërkojnë përjashtimin e gjyqtarëve dhe vëzhguesve nga lista e aprovuar nga Bordi i FBK-së, apo nga ndeshja në të cilën është deleguar.

32.4. Gjyqtarët janë plotësisht të pavarur për marrjen e vendimeve. Janë të obliguar që me çdo kusht, nëse ekzistojnë kushtet normale, ta sjellin ndeshjen deri në përfundim të saj.

32.5. Gjyqtari i parë posaçërisht është përgjegjës për fushëveprimin tij, të përcaktuar me Rregullat zyrtare të lojës.

32.6. Gjyqtari i parë është përgjegjës edhe për:

32.6.1. Sjelljen e lojtarëve dhe personave zyrtarë gjatë lojës, që janë të ulur në bankinë;

32.6.2. Së bashku me vëzhguesin e ndeshjes vendos për ndërprerjen e ndeshjes dhe për zbrazjen e pjesërishme apo të tërësishme të shikuesve, për anim jo sportiv dhe vulgarë drejtuar ndonjërit prej ekipeve, gjyqtarëve, personave zyrtarë dhe punëtorëve tjerë të basketbollit, si dhe hedhja e gjësëve të forta në fushë, me të cilën rrezikohet siguria e pjesëmarrësve në ndeshje (pas vërejtjes së dytë të dhënë me anë të zëritimit).

32.6.3 Në rast të cenimit të fushës së lojës nga individë të paautorizuar, përdorimi i pajisjeve piroteknike, mjeteve të forta ose objekteve tjera që rrezikojnë vazhdimin e ndeshjes, Gjyqtari i Parë në konsultim me vëzhguesin ka të drejtë të ndërprejë ndeshjen pa tërhequr vërejtjen paraprakisht.

32.6.4.

Së bashku me vëzhguesin e ndeshjes vendos për ndërprerjen e ndeshjes dhe për zbrazjen e pjesërishme apo të tërësishme të palestrës në rast të incidenteve në fushë dhe jashtë saj.

Në këto raste, gjyqtarët janë të obliguar që ndeshjen ta vazhdojnë me zbrazjen e pjesërishme apo të tërësishme (totale) të palestrës, e nëse nuk ekzistojnë kushtet për vazhdimin e saj, ndeshja do të zhvillohet brenda 24 orëve pa prezencën e shikuesve prej kohës dhe rezultatit në momentin e ndërprerjes së ndeshjes.

Shpenzimet e ekipit dhe personave zyrtarë për vazhdimin e ndeshjes në këto rrethana do t'i bartë ekipi që është fajtor për ndërprerjen e ndeshjes.

32.6.5. Me realizimin e sulmit fizik ndaj personave zyrtarë (gjyqtarëve dhe vëzhguesit), ndeshja ndërpritet menjëherë, pa vazhdim, me vendimin e marrë nga Gjyqtari i Parë. Ekipi përgjegjës për ndërprerjen e ndeshjes humb ndeshjen me rezultat zyrtar dhe nuk i takon asnjë pikë në tabelën e klasifikimit.

32.7. Gjyqtarët janë të obliguar të arrijnë në palestër ku do të zhvillohet ndeshja një orë para fillimit të saj, e 20 minuta para fillimit, të dalin në fushë në veshje (uniformë) të gjyqtarëve, matësi i kohës e lëshon orën për matjen e kohës.

32.8. Nuk lejohet që gjyqtarët të kenë veshje (uniformë) të ndryshme gjatë ndeshjes.

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



TEB

Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





32.9. Gjyqtarët janë të obliguar që t'i zbatojnë në tërësi rregullat e lojës dhe interpretimin e tyre nga ana e FIBA-s, si dhe mos të lejojnë shkeljen e dispozitave të këtyre Propozicioneve dhe Rregullores së Garave të FBK-së.

32.10. Gjyqtarët duhet të kenë kujdes në pajtim me rregullat që:

32.10.1. Fanellat e lojtarëve të jenë të njëjta;

32.10.2. Nuk duhet lejuar që lojtari të hyjë në fushë nëse nuk është i veshur si lojtarët tjerë të ekipit;

32.10.3. Për rregullsi në fushë dhe punën e tavolinës zyrtare;

32.10.4. Sjelljet e të gjithë personave në bankinat e të dy ekipeve.

32.11. Gjyqtari, i cili ka marrë vendim për përjashtimin e lojtarit, trajnerit, personit zyrtar, apo ka paraqitur ndonjërin nga personat e cekur në fletëparaqitje, duhet ta lajmërojë (njoftojë) vëzhguesin me arsyet e vendimit të marrë apo paraqitjes me shkrim.

32.12. Gjyqtarët janë të obliguar që në ftesë të vëzhguesit, t'i përshkruajnë të gjitha momentet (rastet) kontestuese të cilat kanë ndodhë në ndeshje, që të përshkruajnë arsyet për gabimet e dhëna teknike dhe përjashtimet (diskualifikimet) e lojtarëve, trajnerëve dhe përfaqësuesve zyrtarë, si dhe vendimet tjera të rëndësishme të cilat nuk kanë të bëjnë me rrjedhën e ndeshjes (zbrazja e pjesërishme apo e tërësishme e shikuesve, etj).

32.13. Gjyqtarët dhe vëzhguesi nuk guxojnë të udhëtojnë në ndeshje me mjetin transportues (automobilin, autobusin etj) të ekipit e cila gjykohet nga ta.

32.14. Komesari i Garave i fton në përgjegjësi dhe i ndëshkon në shkallë të parë gjyqtarët të cilët nuk i respektojnë dispozitat e rregullave të basketbollit, dhe nuk e kryejnë detyrën e tyre sipas këtyre Propozicioneve.

32.15. Komesari i Garave, në shkallë të parë i ndëshkon gjyqtarët të cilët bëjnë shkeljen e Rregullave të Lojës.

32.16. Gjyqtarëve iu ndalohet komentimi i të gjitha detajeve lidhur me ndeshjen e zhvilluar dhe me detajet e cekura në raportin e ndeshjes.

32.17. Pas përfundimit të ndeshjes, gjyqtarët mund ta braktisin fushën vetëm me lejinim e vëzhguesit.

Neni 33. Gjyqtarët ndihmës

33.1. Gjyqtarët ndihmës në ndeshje i cakton ekipi vendës;

33.2. Gjyqtarët ndihmës duhet të jenë të veshur njësoj;

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



TEB

Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





33.3. Gjyqtarët ndihmës të cilët nuk i respektojnë dispozitat e Rregullave të basketbollit dhe detyrën e tyre nuk e kryejnë sipas këtyre Propozicioneve, do të ftohen në përgjegjësi disiplinore dhe do të ndëshkohen nga Komesari i Garave.

33.4. Vëzhguesi i ndeshjes ka të drejtë të përjashtojë nga tavolina zyrtare gjyqtarët të cilët nuk i respektojnë dispozitat e rregullave të basketbollit dhe detyrën e tyre nuk e kryejnë sipas këtyre Propozicioneve. Në këtë rast klubi ka 30 minuta kohë që të gjejë zëvendësimin për gjyqtarin ndihmës të përjashtuar.

33.4. Pas përfundimit të ndeshjes, gjyqtarët ndihmës mund ta braktisin fushën vetëm me lejinim e vëzhguesit.

ANKESA

Neni 34. Ankesa në ndeshje

34.1. Në rast të ankesës së paraqitur nga ekipi i cili mendon se është dëmtuar me vendimet e gjyqtarëve, me paraqitjen e lojtarit i cili nuk është regjistruar sipas Rregullores mbi regjistrimin e lojtarëve, apo me paraqitjen e lojtarit të dënuar, ankesa duhet të bëhet sipas këtyre kushteve:

34.1.1 Kapiteni i ekipit DUHET të nënshkruhet menjëherë në vendin e caktuar pas përfundimit të ndeshjes në Protokollin e ndeshjes.

34.1.2. T'ia dorëzojë vëzhguesit me shkrim sqarimet e ankesës më së voni 15 minuta pas përfundimit të ndeshjes. Pastaj, personat zyrtarë të ndeshjes (gjyqtarët dhe vëzhguesi), secili veç e veç, duhet të japin mendimin me shkrim në lidhje me ankesën, e në rast kërkesës me shkrim të Komesarit të Garave, edhe raportin plotësues.

34.1.3. Klubi duhet të bëjë deponimin e shumës në lartësi prej 500,00€ në llogarinë e FBK-së më së voni në ditën e parë të punës pas përfundimit të ndeshjes.

34.1.4. Klubi mundet, por nuk është i obliguar, të dorëzojë plotësimet e ankesës më së voni ditën e parë të punës pas përfundimit të ndeshjes.

34.2. Ankesa, e cila nuk është lajmëruar me nënshkrimin e kapitenit të ekipit, nuk i është dhënë me kohë vëzhguesit të ndeshjes dhe nuk është bërë deponimi i shumës në afatin e caktuar, do të refuzohet dhe nuk do të merret parasysh.

34.3. Për përcaktimin e terminit të saktë të datës së deponimit të shumës për ankesë do të merret parasysh fletëpagesa postare apo bankare.

34.4. Komesari i Garave mund të marrë vendim për miratimin e ankesës apo refuzimin e saj.

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



TEB

Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





34.5. Nëse ankesa miratohet, Komesari i Garave mund të urdhërojë zhvillimin e serishëm të ndeshjes apo do të regjistrojë me rezultat zyrtar nëse për këtë plotësohen kushtet e përcaktuara me këto propozicione, Rregulloren e Garave dhe Rregullat Zyrtare të Basketbollit. Me miratimin e ankesës nga ana e Komesari të Garave, bëhet kthimi i mjeteve të deponuara në shumë prej 500,00€.

34.6. Nëse ankesa refuzohet Komesari i Garave do të regjistrojë ndeshjen me rezultatin e arritur.

34.7. Vendimin për ankesën e ndeshjes, Komesari duhet ta marrë më së voni 72 orë pas përfundimit të ndeshjes.

34.8. Në ndeshjet e Play-offit, turnetë finale apo tempoja e zhvillimit të ndeshjeve e cila kërkon reagim të shpejtë, Komesari i Garave vendimet duhet t'i sjellë në afat prej 24 orëve pas përfundimit të ndeshjeve, e me këtë duhet të dorëzohen të gjitha dokumentet e nevojshme (ankesa, deklaratat e akterëve, personave zyrtarë etj), duhet t'i dorëzohen Komesarit të Garave në afatin e cekur.

34.9. Për shkak të paraqitjes objektive të fakteve rreth procedurës së ankimit, Komesari i Garave mund të kërkojë nga SHGJFBK (apo komisioni përkatës) mendimin profesional (ekspertizën e gjyqimit), në afat prej 48 orësh pas përfundimit të ndeshjes).

Neni 35 Ankesa në vendimin e Komesarit të Garave

35.1. Në vendimin e Komesarit të Garave është e lejuar ankesa në Komisionin Arbitrar të FBK-së, e cila dorëzohet më së voni 24 orë pas marrjes së vendimit.

35.2. Për ankesë, paraqitësi i ankesës duhet të deponojë në llogarinë e FBK-së shumën prej 300.00 €.

35.3. Ankesa e cila nuk është dorëzuar me kohë tek Komisioni Arbitrar, apo nuk është deponuar shuma e caktuar refuzohet dhe nuk do të shqyrtohet.

35.4. Komisioni Arbitrar vendimin e merr në afat prej 48 orëve. Vendimi i Komisionit Arbitrar është përfundimtar dhe pa të drejtë ankese.

35.5. Në vendimin e Komisionit Arbitrar, pala e pakënaqur ka të drejtë juridike, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë para Bordit të FBK-së, por vetëm në rastin kur mendon se vendimi i Komisionit Arbitrar ka bërë shkelje materiale të akteve normative të FBK-së.

35.6. Gjatë Play-Off-it, pas ankesës së dorëzuar të ekipit, në ftesë të Komesarit të Garave, Komisioni Arbitrar mbledhet dhe menjëherë merr vendim për ankesën e dorëzuar.

35.7. Nëse ankesa aprovohet, shuma e deponuar do t'i kthehet paraqitësit të ankesës.

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



TEB

Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





- 35.8. Ankesat në vendimin e Komesarit të Garave në ndeshjet finale paraqiten dhe shumat deponohen njësoj sikur të pjesa e rregullt e garave.
- 35.9. Komesari i Garave vendimet e veta i shpallë nëpërmjet të postës elektronike.
- 35.10. Në këto vendime paraqitësi i ankesës ka të drejtë ankese në afat prej 24 orëve nga marrja e vendimit, apo dita e publikimit në ueb-faqen e FBK-së.
- 35.11. Ankesa në ndeshjet e Play-offit paraqitet me anë të postës elektronike, apo dorëzohet me shkrim në afat i cili nuk pengon zhvillimin e rregullt të garave.
- 35.12. Vendimi i Komisionit Arbitrar i dërgohet klubeve me anë të postës elektronike dhe publikohet në ueb-faqen e FBK-së. Vendimi nënkuptohet i shpallur në momentin kur i është dërguar klubit apo është publikuar në ueb-faqen e FBK-së.

REGJISTRIMI I NDESHJEVE

Neni 36. Regjistrimi i ndeshjeve

- 36.1. Komesari i Garave bën regjistrimin e ndeshjeve në bazë të raporteve të pranuar nga vëzhguesit e ndeshjeve.
- 39.2. Të gjitha ndeshjet për të cilat ekzistojnë ankesat apo rastet tjera të cilat nuk lejojnë regjistrimin e ndeshjes, Komesari i Garave është i obliguar që t'i regjistrojë në afatin sa më të shkurtër, gjegjësisht, më së voni 7 ditë pas përfundimit të xhiros apo të ndeshjes.
- 36.3. Në rast kur është paraqitur ankesa apo ekzistojnë raste të tjera për të cilat ndeshja nuk mund të jetë e regjistruar, afati i regjistrimit shtyhet (pezullohet) deri në ditën e marrjes së vendimit, gjegjësisht deri në marrjen e vendimit për zgjedhjen e rastit për të cilin ndeshja nuk është regjistruar.
- 36.4. Të gjitha ndeshjet për të cilat nuk ka ankese apo raste të tjera të cilat nuk lejojnë regjistrimin e ndeshjes, Komesari i Garave është i obliguar që t'i regjistrojë 48 orë pas përfundimit të ndeshjeve.
- 36.5. Njëherë ndeshja e regjistruar apo vendimi i marrë nuk mund të anulohet nga ana e organit të njëjtë.

NDARJA E PIKËVE DHE PLASMANI I EKIPEVE

Neni 37. Mënyra e ndarjes së pikëve, përcaktimi i plasmanit

- 37.1. Mënyra e ndarjes së pikëve dhe përcaktimi i plasmanit të ekipeve në sistemin e garave bëhet në bazë të dispozitave, të Rregullave zyrtare të basketbollit, Rregullores së garave dhe këtyre Propozicioneve.

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



TEB

Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





- 37.1.1. Nëse dy skuadra në fund kanë tubuar numër të njëjtë të pikëve, renditja e tyre do të përcaktohet në bazë të ndeshjeve të zhvilluara në mes tyre;
- 37.1.2. Nëse numri i fitoreve në ndeshjet në mes tyre është i barabartë, atëherë renditja përcaktohet në bazë të koshdiferencës në ndeshjet ndërmjet tyre. Nëse koshdiferenca në ndeshjet e zhvilluara në mes tyre është e njëjtë, atëherë renditja përcaktohet në bazë të koshdiferencës duke llogaritur rezultatet e arritura në të gjitha ndeshjet e zhvilluara të të dy skuadrave gjatë edicionit garues;
- 37.1.3. Koshdiferenca llogaritet duke zbritur numrin e koshave të shënuar me numrin e koshave të pësuar;
- 37.1.4. Nëse më shumë se dy skuadra kanë tubuar numër të njëjtë të pikëve, renditja përcaktohet vetëm në bazë të rezultateve të arritura në ndeshjet në mes tyre;
- 37.1.5. Nëse më shumë se dy skuadra kanë tubuar numër të njëjtë të pikëve dhe numri i fitoreve në ndeshjet në mes tyre është i barabartë, renditja përcaktohet në bazë të koshdiferencës në ndeshjet e zhvilluara në mes tyre.
- 37.1.6. Nëse më shumë se dy skuadra kanë numër të barabartë të fitoreve dhe koshdiferencë të njëjtë në ndeshjet e zhvilluara në mes tyre, renditja caktohet në bazë të koshdiferencës duke i llogaritur të gjitha ndeshjet e zhvilluara gjatë edicionit garues;
- 37.1.7. Nëse edhe koshdiferenca është e njëjtë, renditja do të caktohet në bazë të hedhjes së shortit.
- 37.1.8. Procedurën e hedhjes së shortit e cakton dhe e zbaton Komesari i Garave, në prani të përfaqësuesve të skuadrave;
- 37.2. Mënyra e përcaktimit të plasmanit të skuadrave do të zbatohet në pjesën e parë të edicionit, pas zhvillimit të të gjitha ndeshjeve, dhe pas përfundimit të edicionit garues.

DISPOZITAT FINANCIARE

Neni 38 Sanksionet

- 38.1. Klubet janë të obliguara që obligimet e tyre financiare t'i paguajnë:
- 38.1.1. Borxhet nga edicioni i kaluar, në bazë të Vendimit të Bordit apo më së voni 15 ditë para fillimit të edicionit të ri garues;
- 38.1.2. Më së voni 8 orë para fillimit të ndeshjes për dënimet e shqiptuara në ndeshjet e rregullta të edicionit garues;
- 38.1.3. Më së voni 8 orë para fillimit të ndeshjeve të Play-Off-it për obligimet e bëra;

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



TEB

Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





38.1.4. Paguesa e dënimeve dhe obligimeve tjera materiale, bëhet nëpërmjet bankës ose në mënyrë elektronike. Rreptësisht ndalohet pagesa e dënimeve me para në dorë (cash).

38.1.5. Paguesa e dënimeve dhe obligimeve tjera për shkak të sjelljes së shikuesve ose organizmit të dobët të ndeshjes mund të paguhet deri në afatin prej 8 orësh para fillimit të ndeshjes së ardhshme si vendës.

38.2. Nëse obligimet financiare nuk paguhet në afate të caktuara, Komesari i Garave do të marrë vendim për suspendim. Gjatë kohës së suspendimit, lojtari, ose cilido anëtar apo zyrtar i klubit, gjegjësisht klubi nuk ka të drejtë paraqitjeje në asnjë aktivitet të organizuar nga FBK. Klubi humb ndeshjen me rezultat zyrtar 20:0 dhe nuk merr pikë për këtë ndeshje. Suspendimi vlen deri në pagesën e obligimeve të lojtarit apo klubit. Me pagesën e obligimit financiar suspendimi automatikisht nuk vlen më.

NENI 39. ANKESA NË VENDIMIN E SUSPENDIMIT TË KLUBIT

39.1. Kundër vendimit të Komesarit të Garave për suspendimin e klubit për shkak të mospagesës së obligimeve, klubi ka të drejtë ankese Komisionit Arbitrar të FBK-së në afat prej 24 orëve nga marrja e vendimit. Ankesa nuk e shtyn zbatimin e vendimit.

39.2. Komisioni Arbitrar bën shqyrtimin e ankesës në vendimin për suspendim e ekipit në afat prej 48 orëve pas marrjes së ankesës. Vendimi i Komisionit Arbitrar është përfundimtar.

SHKELJET DHE DËNIMET

NENI	ORGANIZIMI I NDESHJES	SHUMA E DËNIMIT	
		U18-U16	U14 - U12
40.1	Paraqitja me vonesë e ndeshjes	50.00 €	40.00€
40.2	Ndërrimi i terminit 48 orë para Ndeshjes	50.00 €	40.00€
40.3	Ndërrimi i terminit në këtë afat mund të bëhet vetëm me pëlqimin e klubit dhe Komesarit të Garave me dënim prej	40.00€	30.00€

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



TEB

Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





40.4	Mungesa e mjekut kujdestar Mungesa (numër i pamjaftuar) e pjesëtarëve të PK-së	20.00€	20.00€
40.5	Shërbimi i dobët i kujdestarisë -Mungesa e personit dhe pajisjes për pastrimin e fushës	10.00€	10.00€
40.6	Mos sigurimi i zhveshtoreve për skuadrën mike dhe gjyqtarët	50.00€	30.00€
40.7	Organizimi i dobët i tavolinës zyrtare	40.00€	20.00€
40.8	Pengimi i punës së tavolinës zyrtare, vëzhguesit dhe gjyqtarëve nga ana e personave të pa autorizuar para, gjatë dhe pas ndeshjes	50.00€	35.00€
40.9	Mosvendosja e flamurit shtetëror	10.00€	10.00€
40.12	Mos sigurimi i dy(2) topave për skuadrën mike dhe topit me Logo	20.00€	15.00€
40.13	Mosparaqitja e lojtarëve me logo të FBK, Mosparaqitja e lojtarëve me fanella dhe brekë me ngjyrë të njejtë, dhe dukshmëria jo e mirë e numrave	20.00€	15.00€
40.14	Organizimi i dobët në tërësi sipas konstatimit të vëzhguesit	50.00€	30.00€
40.19	Mungesa e licencave	20.00€	10.00€
NENI 41	ORGANIZIMI I DOBËT- SJELLJA E SHIKUESVE		

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



TEB

Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





41.1	Konsumimi i duhanit	20.00€	10.00€
41.2	Hedhja e gjësendeve të buta në fushë, pasi shikuesve iu është dhënë vërejtje (rrollne të letrave, letra të imëta, qese najlloni etj).	40.00€	30.00€
41.3	Hedhja e gjësendeve të forta të cilat mund të shkaktojnë lëndime (para nga metali, stilolapsa, shishe plastike të mbushura, mjete të ndezura etj).	100.00€	50.00€
41.4	Hedhja e gjësendeve të forta të cilat mund të shkaktojnë lëndime me rrezik për jetë (gurë, karrige, dërrasa etj).	100.00€	50.00€
41.5	Pështyjma në lojtarë dhe persona zyrtarë nga ana e shikuesve	80.00€	50.00€
41.6	Animi dhe sjellja jospportive e shikuesve ndaj: -Gjyqtarëve, lojtarëve, ekipit mik dhe personave zyrtarë -Institucioneve, FBK-së, etj - Animi dhe sjellja jospportive e shikuesve me ofendime nacionale, fetare dhe racore si dhe vendosja e transparenteve me ofendime jospportive, racore dhe nacionale.	50.00€ 50.00€ 50.00€	30.00€ 30.00€ 20.00€
41.8	Nëse animi jospportiv nga neni	500,00€	300.00€

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



TEB

Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



automita

Youth Basketball supporters:



SHITA & ASSOCIATES
LEGAL | TAX | DEVELOPMENT





	41.7. vazhdohet dhe ndërprerja për largimin e shikuesve zgjatë më tepër se 15 min. dhe nëse palestra nuk ka mundësi dhe kushte që të zbrazet, ndeshja do të ndërpritet dhe do të vazhdohet brenda 24 orëve pa prezencën e shikuesve me kohën dhe rezultatin dhe të gjitha shënimet nga protokollin në momentin e ndërprerjes së ndeshjes. Dënimi me para: dhe Dënimi i fushës (sallës) pa prezencën e shikuesve:	1-2 Ndeshje	1-2 Ndeshje
41.9	Nëse në fushë hedhen gjësende të forta nga neni 41.3. dhe 41.4. dhe të njëjtat lëndojnë lojtarët, trajnerët, personat zyrtarë dhe ndeshja ndërpritet pa vërejtjen e dhënë. Dënimi me para: dhe Dënimi i fushës (sallës)	500.00€ 1-2 Ndeshje	300.00€ 1-2 Ndeshje
41.10	Hedhja në fushë apo në tribuna të petardëve, bombave tymi apo ndezja e fishekzjarrëve para dhe gjatë ndeshjes, të cilat shkaktojnë dukshmëri të dobët apo kushte të padurueshme për shikimin e ndeshjes	100.00€	80.00€

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



TEB

General Sponsor:

Golden Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





41.11	Nëse dukshmëria e dobët dhe tymi shkaktojnë probleme dhe pa mundësi të vazhdimet të ndeshjes (shikuesve iu është dhënë vërejtje dhe ata vazhdojnë me piroteknikë) për ndeshjen e ndërprerë më tepër se 15 min. do të zbatohet neni 41.8. i Propozicioneve Dënimi me para: dhe Dënimi i fushës (sallës) pa prezencën e shikuesve:	500.00€ 1-1 Ndeshje	300.00€ 1-2 Ndeshje
41.12	Hyrja e personave jozyrtarë në fushë para, gjatë dhe pas ndeshjes -Hyrja e personave zyrtarë (udhëheqësi teknik, përfaqësuesi zyrtar, udhëheqësi etj) në lokalin ku përpilohet raporti i vëzhguesit.	100.00€ 50.00€	50.00€ 50.00€
41.13	Në rast të agresivitetit të këtyre personave- të cilët përpiqen që të realizojnë sulm fizik ndaj ekipit mik, personave zyrtarë dhe të tjerëve në fushë, rreth fushe, korridoreve, lokaleve dhe jashtë sallës Dënimi me para: dhe Dënimi i fushës (sallës) pa prezencën e shikuesve:	500.00€ 2 ndeshje	300.00€ 2 ndeshje
41.14	Nëse është bërë realizimi i sulmit fizik dhe nëse ndeshja ka	500.00€ 3 ndeshje	300.00€ 3 ndeshje

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



TEB

Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





	përfunduar në kohë të rregullt Dënimi me para: Dënimi i fushës (sallës) pa prezencën e shikuesve:		
41.16	Nëse është realizuar sulmi fizik ndaj personave zyrtarë para dhe gjatë ndeshjes, dhe nëse ndeshja është ndërprerë para kalimit të kohës (në pajtim me nenin 39.6.4. të propozicioneve) Dënimi me para: dhe Dënimi i fushës me mos lojë	500.00€ 3 ndeshje	300.00€ 3 ndeshje
Neni 42	LOJTARËT, TRAJNERËT, NDIHMËSTRAJNËRËT, PERSONAT ZYRTARË TË EKIPËVE, ANËTARËT DHE PËRFAQËSUESIT TJERË TË EKIPËVE		
A/	KËRCËNIMET, OFENDIMET, SJELLJET JOSPËRITIVE		
41.1	Gabimi teknik i lojtarit	40.00€	25.00€
42.2	Gabimi teknik i trajnerit	40.00€	25.00€
42.3	Lojtari i përjashtuar (përveç të dy gabimeve të qëllimta në një ndeshje),	100.00€	30.00€

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



TEB

Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



automita

Youth Basketball supporters:





	trajneri dhe ndihmës trajneri suspendohen automatikisht deri në dhënien e dënimit, me ndalimin e paraqitjes në ndeshjen e ardhshme Dënimi me para:		
42.4	Sjellja jospportive, fletëparaqitja nga ana e personave zyrtarë, sjelljet jospportive të konstatuara me transmetim të TV-së, videoxhirimet apo prezenca e Komesarit të Garave në ndeshje Dënimi me para: dhe Dënimi me ndalesë të paraqitjes apo mos ushtrimi i detyrës	100.00€ 1-2 ndeshje	30.00€ 1-2 ndeshje
42.5	Sjellja jospportive, me përpjekje të sulmit fizik dhe pshtyerja ndaj lojtarit kundërshtar, personit zyrtar të klubit apo personave zyrtarë (vëzhguesit, gjyqtarëve dhe gjyqtarëve ndihmës) para, gjatë dhe pas përfundimit të ndeshjes Dënimi me para: dhe Dënimi i fushës (sallës) pa prezencën e shikuesve:	100.00€ 1-2 ndeshje	70.00€ 1-2 ndeshje
42.6	Rrahja ndërmjet veti të lojtarëve kundërshtarë, goditja e lojtarit kundërshtarë para, gjatë dhe pas	1) 100.00€ 2 ndeshje 2) 200.00€ 4 ndeshje	1) 70.00€ 2 ndeshje 2) 150.00€ 4 ndeshje

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



TEB

Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





	përfundimit të ndeshjes Dënimi me para dhe 1. Për pjesëmarrësin-it në rrahje 2 Për nxitësin (iniciatorin) e incidentit		
42.7	Realizimi i sulmit fizik ndaj personave zyrtarë Dënimi me para: dhe Ndalesa e paraqitjes në ndeshje apo ushtrimi të detyrës	500.00€ 1 vit	400.00€ 1 vit
Neni 43	PËRBËRJA E EKIPIT		
43.1	Nëse ekipi nuk paraqitet në përbërjen më të mirë	100.00€	50.00€
43.2	Nëse ekipi paraqitet me më pak se 10 lojtarë në ndeshje, për çdo lojtarë nën numrin 10	30.00€	20.00€
	Në rastet e përsëritura sipas këtij neni në ndeshjet kampionale dhe të kupës dënimet do të dyfishohen		
Neni 46	VEZHguesI, GJYQTARËT DHE GJYQTARËT NDIHMËS.		
46.1	Kryerja e papërgjegjshme e detyrës, mos zbatimi i udhëzimeve dhe vendimeve të Komesarit të Garave,	4 ndeshje mosdelegim	

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



TEB

General Sponsor:

Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





	Propozicioneve të Garave, rregullave zyrtare të lojës		
46.2	Paraqitja jo objektive e fakteve në raport dhe fshehja e fakteve	2-4 ndeshje mosdelegim	
46.3	Dorëzimi jo me kohë i raportit të ndeshjes nga ana e vëzhguesit	4 ndeshje mosdelegim	
46.4	Përdorimi i veshjes jo të rregullt për ndarjen e drejtësisë, mungesa e ndonjë pjese të veshjes uniforme apo veshjes nga kolegët e tij	2 ndeshje mosdelegim	
46.5	Mosparaqitja me kohë në ndeshje (1 orë para fillimit të ndeshjes) 5-15 minuta 15-30 minuta	1 ndeshje 2 ndeshje	
46.6	Mosparaqitja me kohë në ndeshje (1 orë para fillimit të ndeshjes) 5-15 minuta 15-30 minuta	1 ndeshje 2 ndeshje	
46.7	Mosparaqitja e pa arsyeshme në ndeshje deri në përfundimin e edicionit garues	Fshirje nga lista per edicionin garues	
46.8	Konsumimi i alkoolit në ditën e ndarjes së drejtësisë, para fillimit të ndeshjes	5 ndeshje	
46.9	Ndarja jo e mirë e drejtësisë sipas raportit të Kontrollorit të ndeshjes apo shikimit të video xhirimit të ndeshjes	1-2 ndeshje	
46.10	Ndarja e dobët e drejtësisë sipas raportit të Kontrollorit	4 ndeshje	

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



TEB

General Sponsor:

Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





	të ndeshjes apo shikimit të video xhirimit të Ndeshjes		
46.11	Bërja e gabimit material të rregullave të lojës sipas vlerësimit të vëzhguesit apo kontrollorit të ndeshjes por pa ndikim të drejtpërdrejtë në rezultatin përfundimtar të Ndeshjes	4 ndeshje	
46.12	Bërja e gabimit material të rregullave të lojës me ndikim të drejtpërdrejtë në rezultatin përfundimtar të ndeshjes	10 ndeshje	
46.13	Gjyqtari apo vëzhguesi i cili tenton ose realizon sulmin fizik ndaj lojtarit, trajnerit ose personit zyrtar të skuadrës	Fshirja nga lista për edicionin garues	
46.14	Gjyqtari apo vëzhguesi i cili tenton ose realizon sulmin fizik ndaj kolegut apo vëzhguesit ose vëzhguesit ndaj gjyqtarit	Fshirja nga lista për edicionin garues	
46.14	Gjyqtari apo vëzhguesi i cili tenton ose realizon sulmin fizik ndaj kolegut apo vëzhguesit ose vëzhguesit ndaj gjyqtarit	Fshirja nga lista për edicionin garues	

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



TEB

General Sponsor:

Golden Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





46.14	Gjyqtari apo vëzhguesi i cili tenton ose realizon sulmin fizik ndaj kolegut apo vëzhguesit ose vëzhguesit ndaj gjyqtarit	Fshirja nga lista për edicionin garues	
46.15	Gjyqtari apo vëzhguesi i cili nuk merr pjesë në seminarët dhe testimet e obliguara para dhe gjatë edicionit garues Abstenimi nga ndeshja	Fshirja nga lista për edicionin garues	
46.15	Gjyqtari i dënuar tri (3) herë për shkak të mos respektimit të nenit 46.1-46.12	Fshirja nga lista për edicionin garues	
46.16	Gjyqtari apo vëzhguesi i cili publikisht kritikon vendimet e marrura të FBK, punën e komesarit të Garave dhe Komisioneve të FBK	Fshirja nga lista për edicionin garues	

Komesari i Garave në shkallë të parë i shqipton dënimet për shkeljet e përcaktuara me këto Propozicione të Garave.

Neni 47.2. Komesari i Garave mund të shqiptojë dënime sipas këtyre kriterëve për akterët e ndeshjeve edhe pse ata nuk janë shënuar dhe nuk janë sanksionuar nga ana e vëzhguesit dhe gjyqtarët, por është konstatuar nga video xhirimet e ndeshjes apo prezencës së tij në ndeshje.

Neni 47.3. Për shkeljet e rënda të lojtarëve, trajnerëve, përfaqësuesve zyrtarë të klubeve dhe përfaqësuesve zyrtarë në ndeshje, dënimet shqiptohen edhe në bazë të Rregullores Disiplinore të FBK-së.

Neni 47.4. Dënimet e shqiptuara për ndalimin e paraqitjes në ndeshje, gjegjësisht kryerjes së detyrës në numër të caktuar të ndeshjeve, zbatohet sipas tempos së delegimit, në pajtim me orarin dhe kalendarin e garave kampionale dhe të Kupës.

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



TEB

Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





Neni 47.5. Në rast që dënimi i shqiptuar nuk ka kaluar në edicionin garues ai do të bartet në edicionin e ardhshëm garues pa marrë parasysh në ndërrimin eventual të shkallës së garave, klubit apo emërimit.

Neni 47.6. Personit të cilit i është shqiptuar dënimi kohor, gjatë kohës së mbajtjes së dënimit nuk mund të ushtrojë asnjë detyrë në sportin e basketbollit. Dënimi i shqiptuar kohor nga trupat e autorizuara botërore, evropiane dhe regjionale do të vlejë edhe në ndeshjet e zhvilluara në FBK.

Neni 47.7. Në rast të shqiptimit të dënimit të një shkelësi, për dy apo më tepër shkelje në një ndeshje, dënimi i tërësishëm duhet të jetë diçka më i vogël se sa mbledhja e të gjitha dënimeve.

Neni 47.8. Nëse ekipi në ndeshje paraqitet me lojtarin i cili nuk ka të drejtë paraqitjeje, apo ekipi nuk posedon licencën e lëshuar nga komisioni për regjistrim (Komesari i Garave), apo ndeshjen e udhëheqë trajneri i dënuar, kjo skuadër e humb ndeshjen me rezultat zyrtar 20:0 dhe nuk merr asnjë pikë.

Neni 47.9. Nëse ekipi nuk paraqitet pa arsye për zhvillimin e ndeshjes, ndeshjen e humb me rezultat 20:0 dhe nuk merr asnjë pikë.

Neni 47.10. Ekipi që në një edicion garues humb 2 ndeshje të përshkruara me nenin 47.8. dhe 47.9. do të largohet nga garat e mëtuqeshme dhe në vitin e ardhshëm garues nuk mund të paraqitet në të njëjtën ligë të garave.

Neni 47.11. Ekipi që e braktisë në mënyrë arbitrare fushën e lojës para përfundimit të ndeshjes dhe nuk kthehet për vazhdimin e ndeshjes pas kohës së Time-out të mbetur për atë periudhë apo në ftesë të gjyqtarit të parë, do të largohet nga garat e mëtuqeshme dhe në edicionin e ardhshëm garues nuk ka të drejtë të paraqitet në atë rang garash.

Neni 47.12. Nëse skuadra pa arsye nuk paraqitet për zhvillimin e ndeshjes së play-offit” më i mirë nga tri ndeshje” apo në mënyrë arbitrare e braktisë fushën dhe nuk kthehet për të vazhduar ndeshjen në ftesë të gjyqtarit të parë, i humb të gjitha ndeshjet në fazën e garave të Play-Off-it. Dënohet me 2.000€ dhe bie në rang më të ulët.

Neni 47.13. Nëse ekipi pa arsye nuk paraqitet për zhvillimin e ndeshjes së Play-offit apo e braktisë ndeshjen “më i mirë nga pesë ndeshjet” do të dënohet me

2.000€ kurse me rastin e përsëritjes do të dënohet me 4.000€ dhe i humb të gjitha ndeshjet në fazën e mbetur të garave të Play-off-it dhe në edicionin e ardhshëm garues nuk ka të drejtë të paraqitet në atë rang garash.

Neni 48. Dënimi i ndalesës për zhvillimin e ndeshjes në fushën e saj

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



TEB

Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





Neni 48.1. Në rast që klubi vendës është dënuar me ndalesë të zhvillimit të ndeshjeve në fushën e tij, duhet:

Neni 48.1.1. Që të caktojë vendin për zhvillimin e ndeshjes i cili është në largësi më së paku prej 30km nga vendi për të cilin është caktuar dënimi dhe palestrën e cila është e licencuar për zhvillimin e ndeshjeve kampionale.

Neni 48.1.2. Fusha e cila është caktuar për zhvillimin e ndeshjes mund të jetë edhe në qytetin nga është kundërshtari, por nuk guxon të zhvillohet në sallën ku skuadra kundërshtare paraqitet si skuadër vendase.

Neni 48.1.3. Nëse ndeshja zhvillohet në fushën e cila në krahasim me fushën e dënuar është në distancë më të madhe, skuadra vendëse është e obliguar që ekipit mike t'ia kompensojë ndryshimin e shpenzimeve të udhëtimit. Ndryshimin e shpenzimeve të udhëtimit e përcakton Komesari i Garave pas pranimit të dokumentacionit komplet për mënyrën e udhëtimit të skuadrës mike.

Neni 49 Dënimi dhe ndalesën e prezencës së shikuesve

Neni 49.1. Në rast që ekipi vendës-organizatori është dënuar që ndeshjet vendase t'i zhvillojnë pa prezencën e shikuesve, është e obliguar:

Neni 49.1.1. Që të sigurojë palestrën e regjistruar për atë nivel të garave.

Neni 49.1.2. Vlejnë dispozitat e nenit 48.1.2 dhe 48.1.3.

Neni 49.1.3. Që të sigurojë që në palestër, përveç ekipeve të jenë të pranishëm vetëm personat zyrtarë, kujdestarët, organi për sigurim dhe përfaqësuesit e mjeteve të informimit publik.

Neni 49.2. Delegati i ndeshjes është i autorizuar që të kërkojë nga organizatori largimin e të gjithë personave jozyrtarë nga palestra, para apo nëse është e nevojshme edhe gjatë ndeshjes, kurse vëzhguesi nuk guxon të lejojë që ndeshja të fillojë pa u plotësuar këto kushte.

Neni 50 Evidenca e dënimeve të shqiptuara

Neni 50.1. Komesari i Garave dhe administrata janë të obliguar që nëpërmjet të informatorëve të informojnë për dënimet e shqiptuara sipas xhirove apo kohës me terminet e sakta të caktuara.

Neni 50.2. Në rastet urgjente informimi kryhet nëpërmjet postës elektronike, kurse përmbajtja në informatorin e ardhshëm.

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



TEB

Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





Neni 50.3. Komesari i Garave para çdo edicioni garues njofton për obligimet e klubeve dhe dënimet nga edicioni i kaluar garues. Në të kundërtën klubet mbajnë përgjegjësi për lëshimet eventuale sipas këtij qëndrimi

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE Neni 51 AKTET E FIBA-s

51.1. Të gjitha rastet të cilat nuk janë paraparë, apo nuk janë përfshirë në këto Propozicione, Komesari i Garave i zgjedh me zbatimin e akteve të përgjithshme të Federatës Ndërkombëtare të Basketbollit-FIBA.

Neni 52. Mënyra e miratimit, ndërrimeve dhe plotësimeve të Propozicioneve

52.1. Propozicionet e garave i miraton Bordi i FBK-së në propozim të Komesarit të Garave.

52.2. Ndërrimet dhe plotësimet e këtyre Propozicioneve miratohen sipas procedurës së njëjtë të aprovimit të tyre.

52.3. Interpretimin e këtyre Propozicioneve e jep Bordi i FBK-së, në mënyre direkte apo nëpërmjet të Komisioneve të tij.

52.4. Bordi i FBK-së autorizon dhe obligon Komesarin e Garave të FBK-së që të përpunojë dhe të jep tekstin e konsoliduar të Propozicioneve të garave.

52.5. Këto Propozicione të garave hyjnë në fuqi me miratimin e tyre nga ana e Bordit të FBK-së dhe do të zbatohen për edicionin garues 2021/2022.

KOMESARI I GARAVE PËR KATEGORITË E REJA

Xhedral Mumini

KRYETARI I FBK-së

Arben Fetahu

Federata e Basketbollit e Kosovës

Prishtinë, 03.10.2022



Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:

Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

**Federata e Basketbollit
të Kosovës**

+383 49 738 080
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Faza 2
Str: Radovan Zogoviç
10 000 Prishtina

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:

